- Потребно е попрецизно доуредување на одредбите за начинот на достава, почеста примена од страна на судовите на одредбите за казнување поради нејавување на судска покана, презентирање на законските одредби за задолжителноста на јавување на судска покана и можноста за казнување во случај на нејавување на судска покана во јавноста, за подигнување на свеста кај граѓаните.
- Од друга страна, различното уредување на скратената постапка, пред сè во начинот на постапување на јавниот обвинител во претходната постапка, како и во начинот на контрола на обвинение, доведува до одложување на главните расправи токму во овие постапки кои по својата суштина треба да се поедноставни од редовното постапување.
- Треба да се размисли за промена на начинот на повикување на лица на главна расправа. Ова посебно од аспект што судовите за учесниците во постапката, оштетениот, сведоците и вештаците, немаат никакви податоци освен оние дадени од странките - име и презиме и адреса на живеење, па во праксата дополнителни податоци со кои би се обратиле до МВР.
- Измени во правец на подготвително рочиште пред судот, на кое би се утврдиле доказите кои ќе се изведуваат, би се расправиле прашањата за евентуални приговори на предложени докази од спротивната страна и би се утврдиле термините за одржување на главна расправа, би биле од корист за одржување на расправата во континуитет.
- Проблемот со недоволната екипираност на јавното обвинителство, не само недостаток на јавни обвинители, туку и воопшто на останатите лица кои се дел од него, и по две години од примена на законот не е решен.
- Потребна е ангажираност на сите надлежни органи во надминувањето на проблемите со спровод посебно на осудените, но и на притворените лица. Овој проблем е најизразен кај КПУ Идризово, иако го има и во другите установи.
- Во делот на воведен говор како фаза на главна расправа, да се направат напори во правец на воедначување на постапувањето

на релација редовна-скратена постапка. Воведниот говор мора да биде посериозно сфатен од странките од аспект на неговата важност на судот да му се нагласи во кој правец ќе се одвива главната расправа и што ќе се докажува, а истовремено неговото значење и за секоја странка да ги слушне и да се подготви за доказите на спротивната странка.

- Уредно дадените поуки за правата на обвинетиот, залагањето на судот да се увери дека обвинетиот разбира за што се обвинува и ако не разбрал да му се даде разбирливо појанување, се од есенцијална важност за законито постапување и запазување на начелото на фер судење. Судовите не смеат да си дозволат спротивно постапување.
- Изјаснувањето на обвинетото лице дали се чувствува виновно за кривичното дело/а за кое се обвинува, не смее да биде извршено под било каков притисок, вклучувајќи ја и сугестијата на судот дека само во случај на признание на вината, при изрекување на казната, може да бидат применети одредбите за ублажување на казна.
- Во делот за редоследот на изведувањето на доказите на главна расправа, истиот треба да биде почитуван за да се оствари самата суштина на постапувањето. Реално поради практичните проблеми во обезбедување на присуство на повиканите лица на расправата, ефикасноста и економичноста на постапување доведуваат до одлука на судот за промена на редоследот. Потребно е воедначување на праксата, во склоп со евентуалните измени како под 1.
- Директното и вкрстено испитување се уште се новина за странките. И од впечатокот на набљудувачите но и од фактот што во голем број на предметите судовите го користат своето право да поставуваат прашања, пред се за доразјаснување на исказите, укажуваат дека во овој правец треба интензивно и постојано обучување на обвинителите и бранителите.
- Судовите, од друга страна, мора да го ограничат оваа свое право само на појаснување на искажаното од сведокот одн. вештото лице и да не ја преземаат на себе улогата на испитувач.
- Да се почитува правото на осомниченото лице да биде известно за правото да се спогодува со овластениот тужител уште при првото известување за неговите права, односно, уште

при лишувањето од слобода. Правото на спогодување треба да биде наведено во листата на правата која би им била напишено достапна на лицата лишени од слобода.

- Да се воведат обврска осомничените задолжително да се поучат на правото на бесплатна помош од бранител, и тоа да биде дел од пишаната листа на поуки за правата.
- Пристап до бранител за сиромашни треба да се обезбеди во сите критични фази на постапката против лицето, почнувајќи од распитот во полиција.
- Финансиските критериуми за право на бесплатен бранител за сиромашни треба да се поедностават по примерот на Законот за правда за детето и на европските држави.
- Да се обезбеди соодветна контрола на судот врз адекватноста и стручноста на помошта што ја даваат адвокатите по службена должност. Надоместот на овие адвокати платени од државата, исто така, мора да биде правичен за да стимулира професионалност и ефективност на одбраната.
- Нужно е јакнење на процесните права на одбраната, особено преку нормативното прецизирање на нејзините права поврзани со увид во списите и присуство при преземањето на истражните дејствија, како и јакнење на надзор на судот врз текот на истрагата кога се во прашање слободите и правата на обвинетите, со цел да се избегнат грешки во оваа фаза од постапката.

Koalicioni “Të gjithë për gjykim të drejtë” – Shkup
Misioni i OSBE në Shkup

Dr. Gordan Kallajxhiev,
profesor ordiner i Fakultetit Juridik në Shkup

Maja Denkovska,
gjyqtare e Gjykatës Themelore Kumanovë

ANALIZA E TË DHËNAVE NGA MONITORIMI I PROCEDURAVE GJYQËSORE NË VITIN 2015

Dr. Gordan Kallajxhiev,
profesor ordiner i Fakultetit Juridik në Shkup

Maja Denkovska,
gjyqtare e Gjykatës Themelore Kumanovë



Mbështetur nga



Përmbajtja e këtij publikimi nuk përfaqëson medoemos këndvështrimin apo qëndrimin e Misionit të OSBE-së në Shkup. Misioni i përmbahet vendimit PC.DEC/81 të Këshillit të Përhershëm të OSBE-së.

Shkup, Dhjetor 2015

Shkurtesa të përdorura:

KEDNJ	Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut
GJEDNJ	Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut
BE	Bashkimi Evropian
LPP	Ligji për procedurë penale
PP	Prokuroria Publike
KP	Kodi Penal
MPB	Ministria e Punëve të Brendshme
OSBE	Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë
SHBA	Shtetet e Bashkuara të Amerikës

HYRJE

Reforma e sistemit juridik-penal në shtet, e cila zbatohet një periudhë më të gjatë kohore, e përfshiu edhe reformën e procedurës penale.

Përgjatë viteve të zbatimit të Ligjit paraprak në fuqi të procedurës penale, në një periudhë të caktuar kohore u bë e qartë se disa rregulla ose parime të caktuara tanimë nuk janë efikase.

Sistemi inkuizitor i modelit kontinental, i cili zbatohet në shtetin tonë, gjykatës ia parashikonte rolin kryesor, duke filluar nga hetimi dhe deri te përfundimi i procedurës, madje gjykata e kishte barrën kryesore për zbatimin e procedurës por edhe të mbledhjes së provave. Sistemi i këtillë bazohet në bindjen se gjykata do të mund, në mënyrë të paanshme dhe objektive, ta konfirmojë të vërtetën dhe ta arrijë drejtësinë. Kjo, njëkohësisht ishte edhe dobësia e saj më e madhe, konflikti i interesave midis funksionit hetues të gjykatës dhe funksionit mbrojtës – t'i mbrojtë qytetarët nga ndjekjet e pabazuara dhe nga cenimi i të drejtave dhe lirive të tyre.

Konflikti i këtillë i interesave në të drejtën e procedurës penale, kah fundi i mijëvjeçarit të kaluar dhe në fillim të këtij mijëvjeçari, rezultoi me tendencën e reformës së procedurës në më shumë shtete evropiane, në drejtim të braktisjes së modelit inkuizitor dhe pranimit të modelit të ri, model i veçantë i procedurës akuzatore.

4

Tendenca dhe praktika e përgjithshme evropiane e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, veçanërisht vendimet e miratuara në procedurat kundër shtetit, e vunë në dukje nevojën e modernizimit të ideologjisë së procedurës penale dhe përforcimin e të drejtave të njeriut gjatë procedurës dhe respektimin e parimit të gjykimit të ndershëm.

Shteti ynë, si edhe shumica e shteteve të rajonit, gjatë zbatimit të reformës të së drejtës procedurale, u përcaktua për braktisje të plotë të paternalizmit gjyqësor dhe inkorporimit të procedurës së palëve, edhe atë gjatë gjithë rrjedhës së procedurës.

Ndryshimet e miratuara më së shumti vinë në shprehje në pjesën e procedurës paraprake, në të cilën mblidhen provat si dhe në fazën e gjykimit, me ç'rast të njëjtat nxirren në seancë gjyqësore, përmes pyetjeve të kryqëzuara.

Ligji i ri për procedurë penale, i cili filloi të zbatohet më datë 01.12.2013, prokurorit publik ia parashikon rolin udhëheqës kryesor në procedurën paraprake, ndërsa gjykatës ia përcakton rolin e kontrollorit të ligjshmërisë dhe garancinë për respektimin e të drejtave të njeriut, e cila nga hulumtues është shndërruar në kontrollor pasiv të ligjshmërisë së procedurës.

I pandehuri, përkatësisht mbrojtja, në këtë pjesë të procedurës kanë një rol më shumë pasiv, ndërsa pjesëmarrja e tyre aktive është në shqyrtimin kryesor, në të cilin mbrojtja do të duhej të jetë e njoftuar me të gjitha provat e prokurorisë dhe aty ku ka mundësi t'i kontestojë. Megjithatë, mbrojtjes i është dhënë mundësia që vet ti mbledhë provat, të cilat parimisht kanë vlerë të njëjtë si edhe ato të prokurorisë, të drejtën e angazhimit të detektivëve dhe ekspertë – këshilltarë teknik vetjak. Të pandehurit, i cili nuk ka mjete të mjaftueshme të angazhojë mbrojtës, i ofrohet e drejta e ndihmës juridike falas.

Problemi me konfliktin e interesave tek gjykata, i theksuar më lartë, në procedurë është zgjidhur me konceptin e palëve për propozimin dhe nxjerrjen e provave (marrje në pyetje të dëshmitarëve dhe ekspertëve nga ana e palëve, përmes pyetjeve të drejtpërdrejta dhe të kryqëzuara) në shqyrtimin kryesor, ndërkaq gjykata është e autorizuar vetëm në mënyrë plotësuese sipas nevojës të parashtrojë pyetje dhe të urdhërojë super ekspertizë, sipas detyrës zyrtare ose sipas propozimit të palëve, kur për një gjë të këtillë ekzistojnë kushte ligjore dhe kur do të vlerësojë se është e nevojshme.

Është e qartë se reforma e të drejtës procedurale është e papërfunduar, ndërsa Ligji i ri për procedurë penale është vetëm një hap fillestar në këtë drejtim. Koncepti është krejtësisht i ri dhe i panjohur për pjesëmarrësit në procedurë dhe aq më shumë për publikun, sa u përket ndryshimeve kryesore. Nga ana tjetër, vet teksti i ligjit përmban mospërputhje të shumta, si dhe pyetje të pa përgjigjura ose të paqarta, që mes tjerash ka të bëjë me praktikën shumëvjeçare të sistemin inkuizitor dhe pamundësinë që paraprakisht të parashikohen të gjitha dyshimet ose problemet me të cilat do të përballen gjatë zbatimit praktik, ndërsa modeli i ndryshuar i procedurës, edhe përkrah kompleksitetit të tij të plotë, filloi të zbatohet pa përgatitje të plotë të kornizave institucionale të jurisprudencës penale dhe në kushte të botëkuptimit të rrënjosur të pjesëmarrësve në procedurën për rolet e tyre, duke e pasur parasysh zbatimin e gjatë të modelit paraprak.

Duke e pasur parasysh rëndësinë e Ligjit të ri për procedurë penale, duke filluar nga muaji mars i vitit 2014, Koalicioni “Të gjithë për gjykim të drejtë”, në partneritet dhe me mbështetje financiare të Misionit të OSBE në Shkup e zbatoi Projektin përmes së cilit u krijuan të gjitha parakushtet për fillimin e aktiviteteve të monitorimit ndaj lëndëve të cilat zhvillohen sipas Ligjit të ri për procedurë penale. Përkatësisht, në vitin 2014 dy qasje monitorimi u zbatuan nga ana e mbikëqyrësve profesional dhe nga ana e publikut joprofesional të cilët kontribuan që të përpilohet një analizë e brendshme e cila është përdorur në mënyrë komparative edhe për nevojat e këtij Raporti.

Në mënyrë që të fitohet vlerësimi i gjendjes në një pjesë të procedurës – në shqyrtimin kryesor, në drejtim të dhënies së përgjigjes së disa pyetjeve të cilat parashtraheshin edhe para fillimit të zbatimit të ligjit, ndërsa rezultuan edhe nga analiza interne e vitit 2014, ishte e domosdoshme të përpilohet një raport i ri i cili do t’i prezantohet publikut profesional dhe atij më të gjerë. Ky Raport është përgjigje e pyetjes se si në mënyrë praktike zbatohet LPP i ri, si sillen palët, si kuptohen parimet e Ligjit dhe konceptet e të njëjtit, nga të gjithë pjesëmarrësit e procedurës, drejtimet në të cilët do të duhej të lëviznin ndryshimet eventuale të ardhshme të tekstit ligjor (përcaktimi i dispozitave problematike dhe të paqarta, përcaktimi i dispozitave të cilat janë në kundërshtim me parimet ligjore dhe me rregullat e veprimit të palëve dhe gjykatës), por edhe atë se cili është perceptimi dhe të kuptuarit e publikut për rrjedhën e shqyrtimit kryesor dhe publiku, përmes veprimit të këtyllë, a e fiton përshtypjen e realizimit të drejtësisë.

Për këtë shkak në Prill të vitit 2015 filloi Projekti “Fuqizimi i transparencës dhe pavarësisë së gjyqësorit përmes monitorimit profesional dhe joprofesional” si vazhdim i Projektit të vitit të kaluar, i implementuar nga Koalicioni “Të gjithë për gjykim të drejtë” në bashkëpunim dhe me mbështetje financiare të Misionit të OSBE në Shkup.

Për nevojat e Projektit u angazhuan 10 (dhjetë) mbikëqyrës profesionistë (juristë të diplomuar me përvojë shumëvjeçare si mbikëqyrës) dhe 20 (njëzet) mbikëqyrës joprofesionistë (gjatë përzgjedhjes së mbikëqyrësve joprofesionistë u tentua të sigurohet shumëllojshmëria në bazë të gjinisë, moshës, përkatësisë etnike dhe shkallës së arsimimit).

Gjatë procesit të monitorimit, mbikëqyrësit përdornin dy pyetësorë paraprakisht të përpiluar, i pari ishte disenjuar për nevojat e

mbikëqyrësve profesionistë dhe përmban 75 pyetje në të cilat është përfshirë Shqyrtimi Kryesor në përgjithësi, i dyti iu përshtat të kuptuarit të mbikëqyrësve joprofesionistë sa i përket procedurës penale dhe synon përmes të njëjtit të mblidhen provat për perceptimin e publikut të rëndomtë në lidhje me transparencën e gjyqësorit dhe realizimin e drejtësisë.

Raporti u hartua në bazë të rezultateve të fituara nga dy kategoritë e mbikëqyrësve dhe përmban të dhëna nga treqind e pesëdhjetë (350) seanca gjyqësore të monitoruara nga ana e mbikëqyrësve profesionistë dhe nga dyqind (200) seanca gjyqësore të monitoruara nga ana e mbikëqyrësve joprofesionistë.

Me gjithsej pesëqind e pesëdhjetë (550) seanca gjyqësore të monitoruara të procedurave penale, të cilat zhvillohen sipas LPP të ri ky Projekt paraqet aktivitetin më të madh monitorues të zbatuar në gjykatat themelore në mbarë shtetin brenda periudhës njëvjeçare.

Me rëndësi të veçantë në këtë Raport ishte të fitohet një pasqyrë se si gjykata, por edhe palët përballen me numrin e madh të risive në Ligj, të cilat nënkuptojnë procedim krejtësisht të ndryshëm nga i deritanishmi, një rol krejtësisht të ndryshëm gjatë procedimit, por edhe atë se si ballafaqohen me paqartësi dhe mospërputhje të caktuara të dispozitave ligjore.

Në mënyrë që të fitohet një pasqyrë e plotë për zhvillimin e shqyrtimeve kryesore, nga mbikëqyrësit u kërkua që krahas inkorporimit të përgjigjeve në pyetësorët e përpiluar, të japin edhe vërejtje të tyre, për çdo gjë që ata e konsiderojnë se do të jetë e rëndësishme gjatë hartimit të analizës, me çka do të fitohet një pasqyrë relevante e mirëfilltë.


Është e qartë se një analizë e këtillë, e cila përfshin vetëm një pjesë të procedurës, nuk do të mund t'u përgjigjet të gjitha çështjeve të rëndësishme, megjithatë qëllimi do të arrihet edhe nëse ofron ndihmë gjatë përcaktimit të dobësive të dispozitave ligjore, implementimit të tyre të gabueshëm dhe problemeve gjatë zbatimit praktik, të cilët në të ardhmen duhet të shmangen nga ana e organeve kompetente.

A. TË DHËNA TË PËRGJITHSHME


Gjatë procedurës së monitorimit të shqyrtimit kryesor, u monitorua shqyrtimi kryesor nga ana e mbikëqyrësve profesionistë në 255 procedura penale, në gjithsej 350 seanca gjyqësore të shqyrtimeve kryesore, në gjykatat themelore me kompetencë të zgjeruar në gjithë territorin e shtetit, në juridiksionet në kompetencë të katër Gjykatave të Apelit.

Së këtëjmi, në juridiksionin e Gjykatës së Apelit Shkup, në gjykatat themelore Shkup 1, Veles dhe Kumanovë, u monitorua procedura në 93 lëndë, në juridiksionin e Gjykatës së Apelit Shtip, në gjykatat themelore Shtip, Strumicë dhe Koçani në 66 lëndë, në juridiksionin e Gjykatës së Apelit Manastir, në gjykatat themelore Manastir dhe Prilep, në 59 lëndë dhe në juridiksionin e Gjykatës së Apelit Gostivar, në gjykatat themelore Tetovë dhe Gostivar, në 37 lëndë.

Numri i lëndëve të monitoruara sipas gjykatave themelore



Numri i seancave të monitoruara gjyqësore sipas gjykatave themelore



Nga numri i përgjithshëm i seancave gjyqësore të shqyrtimit kryesor për lëndët në të cilat është zbatuar Projekti, 248 seanca gjyqësore janë mbajtur, ndërsa 102 seanca të tjera janë shtyrë.

Për një pjesë të seancave gjyqësore të shtyra, mbikëqyrësit nga gjykata ose nga punonjësit e shërbimit gjyqësor kanë marrë informatë vetëm për shtyrjen e seancës gjyqësore, por jo edhe të dhëna sa i përket procedurës penale, për të cilën fare nuk kanë mundur të vërejnë kurrfarë të dhënash.

Në një pjesë të procedurave në të cilat seancat gjyqësore të shqyrtimit kryesor janë mbajtur, shqyrtimi kryesor ka filluar para fillimit të vet procesit të monitorimit, ose shqyrtimi kryesor është shtyrë dhe nuk ka përfunduar gjatë procesit të monitorimit.

Për këtë shkak, të dhënat e prezantuara në pjesën që vijon të analizës, të cilat kanë të bëjnë me pjesë të ndryshme të shqyrtimit kryesor, varësisht nga faza në të cilën ka qenë shqyrtimi kryesor gjatë kohës së monitorimit të procedurës, janë prezantuar me shifra ose me përqindje, sipas numrit të lëndëve ndaj të cilave janë ndërmarrë ato veprime dhe jo sa i përket numrit të përgjithshëm të procedurave të monitoruara.

Numri i lëndëve të monitoruara, në mbarë territorin e shtetit dhe nga të gjitha juridiksionet e apelit, me të vërtetë mundësoi që të fitohen të dhëna cilësore dhe të qëndrueshme sa u përket të gjitha aspekteve mbi të cilat u fokusua analiza.

Numri i personave të akuzuar në procedura

		Numri i lëndëve	Numri i përgjithshëm i personave në lëndë
Persona të akuzuar	1 person i akuzuar	194	194
	2 persona të akuzuar	36	72
	3 persona të akuzuar	14	42
	4 persona të akuzuar	2	8
	5 persona të akuzuar	2	10
	Gjithsej	248	326
Nuk ka të dhëna		7	


Numri i përgjithshëm i personave të akuzuar në procedurat e monitoruara gjatë Projektit është 326 persona, në gjithsej 248 lëndë, një pjesë e tyre si bashkëkryerës të veprës penale, ndërsa një pjesë të akuzuar për vepra të ndryshme penale, të lidhura ndërmjet tyre (vepër penale Vjedhje e rëndë dhe vepër penale Fshehje, vepra penale të kryera gjatë ngjarjes së njëjtë juridiko-penale, Lëndim i rëndë trupor dhe Lëndim trupor etj.). Për shtatë procedura mungojnë të dhënat për numrin e personave të akuzuar në të njëjtat.

10

Njëkohësisht, nga ana e mbikëqyrësve joprofesionistë u monitoruan shqyrtimet kryesore në 200 procedura penale, në gjykatat themelore me kompetencë të zgjeruar Shkup 1, Veles, Kumanovë, Shtip, Manastir, Ohër, Tetovë dhe Gostivar, në të cilat gjithsej ka pasur 298 persona të akuzuar.


Numri më i madh i procedurave janë zhvilluar për vepra nga Kapitulli i veprave penale kundër pronës, gjithsej 75, menjëherë pas tyre është numri i procedurave për veprat nga Kapitulli i veprave penale kundër jetës dhe trupit, gjithsej 46, që e pasqyron karakteristikën e veprave penale për të cilat më së shpeshti zhvillohen procedura penale.

Vepra penale



Gjatë shqyrtimit kryesor të lëndëve penale, të cilat u monitoruan, gjatë procedurës mbrojtës kanë pasur gjithsej 223 persona të akuzuar, prej të cilëve 195 persona të akuzuar mbrojtësin e kanë angazhuar vet, 28 personave të akuzuar u është caktuar mbrojtës sipas “detyrës zyrtare” nga ana e kryetarit të gjykatës (pjesa më e madhe e mbrojtësve të caktuar sipas detyrës zyrtare janë në procedurat që zhvillohen në mungesë të personit të akuzuar, në përputhje me nenin 365 të LPP). Në lëndët në të cilat 103 persona të akuzuar të tjerë nuk kanë pasur mbrojtës, procedura kundër tyre është zhvilluar për vepra penale për të cilat mbrojtja nuk është e detyrueshme.


E drejta për mbrojtës



Raporti është i ngjashëm edhe në shqyrtimet kryesore në vijim për lëndët penale të cilat u monitoruan nga mbikëqyrësit joprofesionistë: mbrojtës gjatë procedurës gjithsej kanë pasur 224 persona të akuzuar, 19 personave të akuzuar u është caktuar mbrojtës sipas detyrës zyrtare nga ana e kryetarit të gjykatës, ndërsa mbrojtës nuk kanë pasur 55 persona të akuzuar.

Nga procedurat e monitoruara para gjykatave, në 193 lëndë ose në 78%, të lëndëve procedura është zhvilluar sipas dispozitave të LPP për procedurë të shkurtuar (neni 468 deri 481), në 54 lëndë bëhet fjalë për procedurë të rregullt, ndërsa për 8 lëndë nuk ka të dhëna.

Procedura e shkurtuar



Të dhënat për numrin e procedurave të shkurtuara të cilat zhvillohen para gjykatave, gjatë analizës ishin të rëndësishme për shkak të rregullimit të ndryshëm të procedurës së rregullt dhe të shkurtuar në Ligj në disa pjesë të caktuara të shqyrtimit kryesor, por edhe për shkak të dallimeve gjatë zbatimit të procedurës paraprahe.

KUSHTET E ZHVILLIMIT TË SHQYRTIMIT KRYESOR

Ligji për procedurë penale në nenin 359, parashikon se shqyrtimi kryesor zhvillohet pa ndërprerje, ndërsa në rastet kur nuk ka mundësi që shqyrtimi kryesor të përfundojë brenda një seance gjyqësore, kryetari vendos që shqyrtimi kryesor të vazhdojë ditën e ardhshme të punës. Thuaja se në mënyrë identike edhe ligji paraparak i LPP e rregullonte zhvillimin e pandërprerë të shqyrtimit kryesor.

Nga të dhënat e fituara nga shqyrtimet kryesore të lëndëve të monitoruara penale, mund të konstatohet se edhe më tutje ekziston problemi i thirrjes së rregullt dhe sigurimit të prezencës së personave të thirrur në shqyrtimin kryesor, me çka do të krijohet zbatimi praktik i nenit 359 të LPP, ndërsa problem plotësues paraqitet kur në procedurën e shkurtuar, në të cilën personi i akuzuar nuk ka pasur mundësi që parapraakisht t'i propozojë provat e veta, veçanërisht kur bëhet fjalë për dëshmitarë ose për këshilltar

teknik, kështu që gjykata nuk ka mundur që t'i thërras të njëjtit dhe ta sigurojë prezencën e tyre në shqyrtimin kryesor, e që çdoherë çon në shtyrjen e saj.

Dispozitat në vijim të LPP, neni 365, neni 368, në mënyrë të mirëfilltë e parashikojnë mënyrën e veprimit të gjykatës, në rast të mosparaqitjes së të akuzuarit, dëshmitarit ose ekspertit të cilët janë të thirrur në mënyrë të rregullt, ndërkaq nuk paraqiten në shqyrtimin kryesor dhe as që e arsyetojnë mungesën e tyre ose nuk mund t'u dorëzohet fletëthirrja, ndërsa nga rrethanat në mënyrë evidente rezulton se i shmangen pranimit të fletëthirrjes, me urdhër për shoqërim të detyrueshëm të tyre.

Zgjidhja e këtillë ligjore, e vë në dukje atë se dispozita e nenit 359 të LPP, paraqitet si e pazbatueshme në praktikë gjatë fillimit të procedurave para gjykatës. Nuk është e mundur që paraprakisht të dihet nëse një person do të paraqitet para gjykatës, edhe pse është thirrur në mënyrë të rregullt, e as që është realisht e zbatueshme urdhri që i njëjti menjëherë të shoqërohet me detyrim (kohë e nevojshme për dërgesën e urdhrin deri në MPB, mundësitë e MPB menjëherë të veprojnë ndaj të njëjtit, koha e nevojshme për veprimin e njëjtë sipas urdhrin dhe ngjashëm). Nga ana tjetër, ekzistimi i rrethanave prej të cilave në mënyrë evidente rezulton se personi i shmanget pranimit të fletëthirrjes, vetvetiu nënkuptojnë thirrje të njëpasnjëshme të një personi të njëjtë, mosdorëzimi i fletëthirrjes për ndonjë shkak, që të mund të konsiderohet se personi në mënyrë evidente i shmanget pranimit të fletëthirrjes.

Sa u përket shkaqeve të shtyrjes së shqyrtimeve të caktuara kryesore, sipas të dhënave të fituara për 253 lëndë (për 2 lëndë nuk ka të dhëna), në 52 për qind të procedurave të monitoruara kanë qenë të pranishëm të gjithë personat e thirrur, 3 për qind e seancave gjyqësore janë shtyrë për shkak të mungesës së prokurorit publik.

Sipas vërejtjeve të inkorporuara në pyetësorët nga ana e mbikëqyrësve, shkak kryesor për mosparaqitjen e prokurorit publik në seancë të caktuar, ka qenë angazhimi i tij për lëndë tjetër, për çka i ka dërguar gjykatës njoftim, ndërsa në disa raste për shkak të shfrytëzimit të pushimit vjetor dhe pamundësisë që të zëvendësohet me tjetër.

Mungesa e personit të akuzuar si shkak për shtyrjen e seancave të shqyrtimit kryesor vërehet në 19 për qind të lëndëve. Mungesa në seancën gjyqësore e personit të akuzuar, në pjesën më të madhe ka të bëjë me dërgesat e parregullta, por shumë shpesh edhe me mosveprimin e institucioneve ndëshkuese-korrektuese sipas urdhrin të dërguar nga gjykata për shoqërimin e personit të akuzuar i cili gjendet në vuajtjen e dënimit, janë vërejtur edhe dy raste të mos shoqërimin të personit të paraburgosur të cilit i

është përcaktuar masa e paraburgimit dhe disa kur nuk është vepruar sipas urdhrin të gjykatës i dërguar deri në MPB për shoqërim të detyrueshëm të personit të akuzuar.

Janë vërejtur edhe disa raste kur personi i akuzuar është thirrur me rregull, ndërsa nuk është paraqitur në seancë, thuaja se pa përjashtim lëndët janë të juridiksionit të Gjykatës së Apelit Gostivar.

Vetëm në disa raste, personi i akuzuar është gjykuar në mungesë, në përputhje me dispozitat e nenit 365 të LPP ose shqyrtimi kryesor është zhvilluar në mungesë të personit të akuzuar, në përputhje me nenin 479 të LPP.


Për shkak të mungesës së mbrojtësit të personit të akuzuar, janë shtyrë 3% të seancave të caktuara gjyqësore, ndërsa 2% për shkak të mungesës së personit ekspert ose këshilltarit teknik.

Në njërin nga rastet, i cili është shtyrë me kërkesë të mbrojtësit të personit të akuzuar, bëhet fjalë për procedurë në të cilën mbrojtja është e detyrueshme në përputhje me nenin 74 paragrafin 3 të LPP (pas aktakuzës së paraqitur për vepër penale për të cilën parashikohet dënim me burgim prej 10 vjet ose dënim më i rëndë, personi i akuzuar doemos duhet të ketë mbrojtës gjatë kohës së dërgesës së aktakuzës), personi i akuzuar nuk ka pasur mbrojtës të tij, ndërkaj as sipas detyrës zyrtare nuk i është caktuar mbrojtës në fazën e kontrollit të akuzës, por me kërkesë të tij gjatë seancës gjyqësore i është caktuar mbrojtës sipas detyrës zyrtare i cili ka kërkuar shtyrje për përgatitjen e mbrojtjes.

Në 11% të seancave të caktuara gjyqësore ka munguar edhe dëshmitari i thirrur, më së shpeshti për shkak të dërgesës së parregullt, por një pjesë e këtyre seancave janë mbajtur me nxjerrjen e provave të tjera, ndërsa pastaj seanca gjyqësore është shtyrë për shkak të mungesës së dëshmitarit.

Në pjesën e përgjigjeve të mbikëqyrësve, si një shkak tjetër për shtyrjen e shqyrtimit kryesor, e që është 10% e rasteve kur seancat gjyqësore janë shtyrë, në pjesën më të madhe bëhet fjalë për mungesë të të dëmtuarit, ndërsa shkakun ka qenë edhe në lidhje me dërgesën e parregullt edhe me mosparaqitjen e të dëmtuarit në gjyq edhe pse ka pasur provë se është thirrur me rregull.

Janë vërejtur dy raste të shtyrjes për shkak të mungesës së gjyqtarit dhe dy raste për shkak të mungesës së përkthyesit gjyqësor, me vërejtje nga ana e gjykatës se përkthyesit refuzojnë të paraqiten para gjykatës për shkak të shumës së ulët e cila u përcaktohet si kompensim.



Në lidhje me kushtet e zhvillimit të seancës dhe prezencës së personave të thirrur, situata edhe në procedurat e monitoruara nga ana e mbikëqyrësve joprofesionistë është e ngjashme, kështu që në 118 lëndë, të gjithë personat e thirrur kanë qenë të pranishëm në shqyrtimin kryesor dhe seanca është mbajtur, në 8 ka munguar prokurori publik, personi i akuzuar ka munguar në 19 procedura, prej të cilave një pjesë është zhvilluar në mungesë të personit të akuzuar, mbrojtësi ka munguar në dy raste, ndonjë nga dëshmitarët e thirrur nuk është paraqitur në seancën e caktuar në 24 procedura, personi ekspert në 18, në 7 raste ka munguar i dëmtuari (pjesa e shënuar me “të tjera”). Edhe në këto procedura të monitoruara, si shkak i shpeshtë për mungesën e personave të akuzuar, theksohet mosveprimi i institucioneve ndëshkuese-korrektuese sipas urdhrit të gjykatës për shoqërimin e personave të dënuar.

16

Nga mbikëqyrësit, janë vërejtur disa shtyrje të seancave gjyqësore, të cilat dalin jashtë dispozitave të LPP.

Në një lëndë, seanca është shtyrë meqë prokurori publik gjatë seancës para fillimit të shqyrtimit ka paraqitur listë të provave, ndërsa në një rast tjetër ka propozuar prova të reja dhe kjo është pranuar nga gjykata, ndërsa shqyrtimi është shtyrë në mënyrë që të thërriten dëshmitarët e propozuar.

Në një rast, i cili është zhvilluar sipas padisë së paraqitur private dhe në një rast ku paditës ka qenë prokurori publik, pas nxjerrjes së provave të akuzës, paditësi ka propozuar prova të reja, kjo është pranuar nga ana e gjykatës dhe seanca është shtyrë në mënyrë që të thirren dëshmitarët. Në një rast, pas marrjes në pyetje të dëshmitarit të mbrojtjes, paditësi privat ka kërkuar shtyrje të seancës që të përgatitet për pyetjet e kryqëzuara ndërsa gjykata e ka pranuar kërkesën.

Mbikëqyrësit kanë vërejtur edhe dy raste të zhvillimit të shqyrtimit kryesor në mungesë të të akuzuarit, jashtë kushteve të përcaktuara me ligj, megjithatë është e mundur që mbikëqyrësi të mos i ketë poseduar të gjitha të dhënat e nevojshme për vendimin e këtillë të gjykatës, prandaj të njëjtat duhet të merren me rezervë.

Në një rast, i akuzuari nuk ka qenë i pranishëm në shqyrtimin kryesor, është paraqitur bashkëshorti/bashkëshortja i/e saj/tij dhe e ka njoftuar gjykatën se personi është në gjendje depresioni dhe prandaj nuk del nga shtëpia, gjykata e ka zhvilluar shqyrtimin në mungesë të personit të akuzuar sipas dispozitave për procedurë të shkurtuar.

Në rastin e dytë personi i akuzuar, kundër të cilit është përcaktuar masa e paraburgimit, nuk ka qenë prezent gjatë shqyrtimit i cili është mbajtur, me arsyetimin se do ta njoftojë mbrojtësi.

FJALA HYRËSE

Nga miratimi i Ligjit në vitin 2010, deri në fillimin e zbatimit të tij dhe pas fillimit të zbatimit nga data 01.12.2013, janë realizuar një numër i madh i trajnimeve, në organizim të Akademisë për Trajnimin e Gjyqtarëve dhe Prokurorëve Publikë, Dhomës së Avokatisë, MPB, me mbështetjen e Misionit të OSBE dhe Ambasadës së SHBA në Shkup, për shkak të njoftimit të pjesëmarrësve në procedurë (gjyqtarë, prokurorë publikë, avokatë, pjesëtarë të policisë së jurisprudence) me risitë e Ligjit, qëllimin e tyre dhe me zbatimin e drejtë gjatë procedimit.


Fjala hyrëse për herë të parë sanksionohet me këtë Ligj dhe si e këtillë e njëjta ishte e panjohur gjatë procedimit të deritanishëm para gjykatave në vend. Në LPP, e njëjta rregullohet me dispozitat e nenit 379, sipas të cilit shqyrtimi kryesor fillon me mbajtjen e fjalëve hyrëse, fillimisht flet paditësi, pastaj mbrojtësi ose i akuzuari, me atë që për të akuzuarin parashikohet e drejta të mos mbaj fjalë hyrëse.

Në fjalët e hyrëse, palët mund të prononcohen se cilat fakte vendimtare kanë për qëllim t'i dëshmojnë, t'i arsyetojnë provat që do t'i nxjerrin dhe t'i caktojnë pyetjet juridike për të cilat do të diskutojnë, por nuk guxon të prezantohen fakte për gjykimin e mëparshëm të të akuzuarit, e as që mund të prononcohen për të dhënat dhe provat e ofruara të palës kundërshtare.

Prandaj ishte me rëndësi që të analizohet se si në procedurat para gjykatave, palët i zbatojnë dispozitat ligjore në lidhje me fjalën hyrëse dhe

nga përmbajtja e të njëjtës a mund të vërehet se çka ka pala për qëllim të dëshmojë para gjykatës dhe cilat fakte vendimtare do të përpiqet t'i dëshmojë.

A mbajtën palët fjalë hyrëse



Shënim: Të dhënat kanë të bëjnë me 125 lëndë në të cilat mbikëqyrësit kanë filluar ta monitorojnë shqyrtimin kryesor nga fillimi

Fjala hyrëse si e drejtë e palëve që ta njoftojnë gjykatën me pohimet dhe faktet vendimtare të cilat do t'i dëshmojnë para gjykatës, u mbikëqyr në mënyrë të veçantë në procedurat e shkurtuara, nga aspekti i procedimit të gjykatës, duke e pasur parasysh dispozitën e nenit 480 të LPP, e cila parashikon se shqyrtimi kryesor në procedurën e shkurtuar fillon me prezantimin e përmbajtjes së akuzës, për dallim nga përmbajtja e dispozitës së nenit 379 të LPP, ku procedura e rregullt fillon me fjalën hyrëse të palëve.

Theksi i veçantë i procedurës së shkurtuar, u vu në aspekt të domethënies së vet fjalës së hyrjes – palët para fillimit të procedurës së provës të prezantojnë para gjykatës, në mënyrë koncize, çka do të diskutojnë dhe dëshmojnë gjatë procedurës.

Në procedurën e rregullt, i pandehuri që në fazën e hetimit, nga ana e prokurorit publik njoftohet se kundër tij zhvillohet procedurë për vepër penale, merret në pyetje nga prokurori publik dhe i prezantohen provat kundër tij.

Sa u përket veprave penale për të cilat parashikohet dënim me para ose dënim me burgim deri në 5 vjet, përkatësisht për të cilat zbatohet procedurë

e shkurtuar, nuk zbatohet procedurë hetuese, ndërsa këtu bën pjesë edhe procedimi i gjykatës sipas padive të paraqitura private, kështu që më së shpeshti, personi i akuzuar, madje pas pranimit të fletëthirrjes për shqyrtimin kryesor në procedurë të shkurtuar, në bashkëngjitje të së cilës e pranon edhe akuzën edhe padinë private, e kupton se kundër tij zhvillohet procedurë penale dhe për çka akuzohet, ndërsa provat kundër tij dhe përmbajtjen e tyre më së shpeshti i kupton gjatë shqyrtimit kryesor.

Nëse gjatë procedurës së rregullt, fjala hyrëse parashikohet si fillim i shqyrtimit, aq më shumë që fjala hyrëse në procedurën e shkurtuar do të ishte me rëndësi, në mënyrë që jo vetëm gjykata por edhe mbrojtja të mund ta kuptojnë se cilat prova do t'i nxjerr paditësi dhe çka do të dëshmojë prokurori publik/paditësi privat. Me kapërcimin e kësaj faze të shqyrtimit, nëse kështu interpretohet dispozita e nenit 480 të LPP – shqyrtimi kryesor fillon me prezantimin e përmbajtjes së akuzës, përkatësisht nëse interpretohet se dispozita e nenit 379, ka të bëjë vetëm me rastet kur zhvillohet procedurë e rregullt nuk ka kurrfarë kuptimi, as i akuzuari i cili vetëm e ka dëgjuar përmbajtjen e akuzës, ndërsa paraprakisht nuk ka dëgjuar dhe as që është vënë në dijeni për provat e bashkëngjitura ndaj të njëjtës, të thirret që të prononcohet se a ndihet fajtor ose jo.

Nga përmbajtja e analizuar e pyetësorëve rezultoi se praktika gjyqësore është e ndryshme jo vetëm sipas juridiksioneve të Apelit, por edhe sipas gjykatave themelore brenda juridiksionit të njëjtë të Apelit, madje edhe gjykatës së njëjtë.

Në një numër të madh të lëndëve, të cilat janë zhvilluar sipas rregullave të procedurës së shkurtuar, në të cilat është zbatuar monitorimi në shqyrtimin kryesor, palët kanë prezantuar fjalime hyrëse, megjithatë nuk është i vogël numri i lëndëve kur një gjë e këtillë nuk është zbatuar në fazën e procedurës së provës.

Mbikëqyrësit kanë vërejtur edhe disa raste, në të cilat edhe pse është bërë fjalë për procedurë të rregullt, fjala hyrëse është kapërcyer plotësisht si fazë e shqyrtimit kryesor dhe kanë kaluar drejtpërdrejt në fazën e pranimit të fajit nga personi i akuzuar, si dhe një rast në të cilin prokurori nuk ka prezantuar fjalë hyrëse, në vend të kësaj e ka bërë precizimin e akuzës.

Në procedurat e monitoruara penale në të cilat palët e kanë prezantuar fjalën hyrëse, vlerësim i përgjithshëm i mbikëqyrësve është se ashtu siç ka rrjedhur procedura e mbikëqyrjes, palët kanë prezantuar fjalime gjithnjë e më të suksesshme, duke e plotësuar kuptimin e dispozitës ligjore për qëllimin e fjalës hyrëse.

Paditësi (prokurori publik, paditësi privat) në 91 lëndë, ka prezantuar fjalë hyrëse nga e cila në mënyrë të qartë është mundur të kuptohet se cili pohim i paditësit dhe cilat fakte do t'i dëshmojnë para gjykatës, në 6 lëndë paditësi nuk ka pasur sukses përmes fjalës hyrëse ta prezantojë rastin, ndërsa në 11 lëndë paditësi vetëm pjesërisht ka pasur sukses në këtë drejtim. Megjithatë, edhe krahas statistikës së këtyre në favor të prokurorisë, në një numër të madh të procedurave, mbikëqyrësit kanë bërë vërejtje se prokuroria publike vetëm e lexon përmbajtjen e akuzës, duke theksuar se nga provat e paraqitura do t'i dëshmojnë gjykatës se i akuzuari e ka kryer veprën, ndërsa nuk prezanton fjalë hyrëse në kuptimin e mirëfilltë.


Mbrojtësit e të akuzuarve në 50 lëndë kanë pasur fjalë hyrëse të qartë dhe të kuptueshme, në 7 lëndë vetëm pjesërisht kanë pasur sukses në këtë, ndërsa në 4 lëndë, fjala hyrëse e mbrojtësit nuk ka qenë e qartë për mbikëqyrësin.

Është vërejtur edhe rasti kur personi i akuzuar ka pasur më shumë mbrojtës, kështu që në fazën e fjalës hyrëse është shkaktuar debat midis mbrojtësve në lidhje me konceptin e mbrojtjes, me ç'rast njëri nga mbrojtësit e ka braktisur seancën.


Është veçanërisht interesante e dhëna se personat e akuzuar në procedurat në të cilat e kanë shfrytëzuar të drejtën e fjalës hyrëse, kanë qenë të suksesshëm, nga 41 rastet në të cilat personi i akuzuar e ka prezantuar fjalën hyrëse, vetëm në një fjalë hyrëse pjesërisht ka pasur sukses ta prezantojë atë që e dëshmon, në 40 rastet e tjera, në mënyrë të qartë kanë prezantuar se çka do të dëshmojnë para gjykatës.

A kuptohet nga fjala hyrëse se çka pohon pala dhe cilat fakte vendimtare do t'i dëshmojë


Paditësi



Mbrojtësi



I akuzuari




UDHËZIME PËR TË DREJTAT E PERSONIT TË AKUZUAR

Udhëzimet të cilat gjykata ia jep personit të akuzuar, sipas radhës së procedimit në shqyrtimin kryesor, pasojnë menjëherë pas fjalës hyrëse të paditësit dhe të njëjtat janë përcaktuar në nenin 380 të LPP.

Gjykata, sipas dispozitës nga paragrafi 1 të këtij neni, pas fjalës hyrëse të paditësit, do ta pyes të akuzuarin a e kupton për çka është akuzuar dhe nëse bindet se i akuzuari nuk e ka kuptuar për çka është akuzuar, shkurtimisht do ta prezantojë përmbajtjen e akuzës në mënyrë më të kuptueshme për të akuzuarin.

Gjykatat në gjithsej 143 procedura të monitoruara, e kanë respektuar obligimin ligjor të binden se personi i akuzuar e ka kuptuar për çka është akuzuar, ndërsa në njërën nga procedurat, nuk janë parashtruar pyetje në këtë drejtim.

A është pyetur i akuzuari nga gjykata se a ka kuptuar se për çka është akuzuar?



Megjithatë, jo në të gjitha rastet, kur personi i akuzuar është deklaruar se nuk e ka kuptuar, gjykatat e kanë respektuar obligimin e tyre, në mënyrë më të kuptueshme shkurtimisht t'ia prezantojnë përmbajtjen e akuzës. Në 11 raste të këtilla kur i akuzuari është deklaruar se nuk e ka kuptuar akuzën, në një rast nuk i është dhënë sqarim, ndërsa në një rast sqarimi ka qenë vetëm e pjesshëm.

Gjendja është dukshëm më e keqe, tek procedurat e monitoruara nga mbikëqyrësit joprofesionistë. Gjykatat, në gjithsej 142 procedura e kanë

respektuar obligimin ligjor të binden se personi i akuzuar e kupton për çka është akuzuar, në 18 procedura një pyetje e këtillë nuk është parashtruar nga ana e gjykatës.


Sa i përket obligimit të gjykatës, personit të akuzuar i cili është deklaruar se nuk e kupton akuzën kundër tij, në mënyrë më të kuptueshme shkurtimisht t'ia prezantojnë përmbajtjen e akuzës, gjykatat në 54 procedura kanë dhënë sqarime, në 26 procedura personit të akuzuar nuk i është dhënë sqarim nga ana e gjykatës, ndërsa në 8 procedura sqarimi ka qenë vetëm i pjesshëm.

Gjykata, sipas paragrafit 2 të nenit 380, pastaj do ta udhëzojë të akuzuarin për të drejtën e heshtjes ose të jap deklaram gojor dhe do ta këshillojë ta ndjek me kujdes rrjedhën e shqyrtimit kryesor, me ç'rast do t'ia bëjë me dije se mund të nxjerr prova në mbrojtje të tij, t'iu parashtrojë pyetje bashkë të akuzuarve, dëshmitarëve dhe ekspertëve dhe të bëjë vërejtje në lidhje me deklaramet e tyre gojore.

Edhe pse në këtë dispozitë të Ligjit nuk janë parashikuar udhëzimet e të drejtës për mbrojtës nga neni 71 të LPP dhe të drejtës për përkthyes nga neni 9 të LPP, të njëjtat ishin pjesë e pyetësorëve të mbikëqyrësve, si të drejta të çdo personi të akuzuar.

Procedimi i gjykatave në pjesën e udhëzimeve për personin e akuzuar në lidhje me të drejtat e tij, ka qenë në nivel të lartë në pjesën më të madhe të procedurave të monitoruara, në të cilat mbikëqyrësit kanë marrë pjesë në fazën fillestare të shqyrtimit kryesor, e kanë udhëzuar personin e akuzuar me të gjitha të drejtat e tij dhe me të drejtat e parashikuara në nenin 380 dhe me të drejtën për mbrojtës sipas zgjedhjes personale dhe të drejtën për përkthyes kur për një gjë të këtillë ka pasur nevojë. Mbikëqyrësit kanë vërejtur 5 procedura në të cilat i akuzuari nuk është udhëzuar fare për të drejtat ose nuk është udhëzuar për të gjitha të drejtat.

Raporti i prezantuar në përqindje ka të bëjë me të gjitha procedurat, megjithatë nga raporti i ndërsjellë i përqindjeve për secilin nga udhëzimet e dhëna personit të akuzuar, mund të vërehet se ai është thujja se identik.



Nga ana tjetër, shifrat nuk e pasqyrojnë çdoherë gjendjen e vërtetë të çështjeve, meqë mbikëqyrësit në vërejtjet e tyre në disa raste kanë konstatuar veprime diametralisht të kundërta të gjykatave: në një pjesë të procedurave gjykata është përpjekur personit të akuzuar, veçanërisht kur nuk ka pasur mbrojtës, t’ia sqarojë procedurën dhe të drejtat, megjithatë ka pasur edhe veprime të kundërta kur sqarimet për procedurën dhe të drejtat janë dhënë përciptazi dhe në mënyrë formale, ndërsa personat e akuzuar kanë lënë përshtypje se nuk e kanë kuptuar as procedurën dhe as të drejtat e tyre.

Konkluzioni i këtillë në lidhje me atë se statistika çdoherë nuk jep pasqyrë reale, konfirmohet edhe me të dhënat e fituara nga ana e mbikëqyrësve joprofesionistë, të cilët kanë vërejtur një numër prej 22 personave të akuzuar, përkatësisht 18% të cilëve nuk u janë prezantuar udhëzimet për të gjitha të drejtat ose fare nuk u është prezantuar udhëzimi për të drejtat.

PRANIMI I FAJIT NGA ANA E PERSONIT TË AKUZUAR

Njëra nga risitë më të rëndësishme gjatë procedimit të lëndëve penale është përcaktuar në paragrafin 3 të nenit 380, si dhe në nenin 381 të LPP. Gjykata, pasi që e ka udhëzuar personin e akuzuar me të drejtat e tij do ta thërras të deklarohet – a ndihet fajtor ose jo në lidhje me të gjitha veprat penale që i përmban akuza, ndërsa nëse personi i akuzuar e pranon fajin, lidhur me një pjesë ose për të gjitha veprat penale me të cilat akuzohet,

gjykata, në pjesën e mëtutjeshme të procedurës, do t'i nxjerr vetëm ato prova që kanë të bëjnë me vendimin e sanksionit, ndërkaq aktgjykimi i miratuar si rezultat i pranimit të fajit nga ana e të akuzuarit në shqyrtimin kryesor, nuk mund të përgënjeshtrohet me ankesë për shkak të gjendjes faktike të përcaktuar gabimisht.

Zgjidhja e këtillë ligjore, dukshëm dallon nga obligimi i gjykatës i parashikuar në LPP, i cili zbatohet deri më datë 01.12.2013, sipas të cilit, pranimi i fajit nga ana e personit të akuzuar, nuk e lironte gjykatën nga obligimi që të nxjerrë prova në lidhje me veprën penale dhe kryerësin.

Së këtejmi, me qëllim të mbrojtjes së të drejtave të personit të akuzuar, Ligji në nenin 381 paragrafin 2, e ka përcaktuar obligimin e gjykatës ta shqyrtojë nëse pranimi i fajit është vullnetar, i akuzuari a është i vetëdijshëm për pasojat ligjore nga pranimi i fajit, për pasojat në lidhje me kërkesën pronësore-juridike dhe për shpenzimet e procedurës penale.

Në këtë pjesë të procedurës penale, monitorimi i procedimit para gjykatave, kishte më shumë aspekte – si funksionon zgjidhja e këtillë ligjore, sa shpesh ndodhë që personi i akuzuar ta pranojë fajin në seancën e shqyrtimit kryesor, nga aspekti i reduktimit të numrit të seancave gjyqësore sipas lëndëve, përkatësisht numrit të lëndëve në të cilat personat e akuzuar e kanë pranuar fajin për veprat penale për të cilat janë akuzuar dhe për këtë shkak nxirren vetëm provat me rëndësi për sanksionin i cili do të shqiptohet; si është sjellja e gjykatës në drejtim të zbatimit të të gjitha kontrolleve të pranimit të fajit, por edhe në drejtim të kontrolleve të pranimit të dhënë, në lidhje me karakteristikat e veprës penale dhe përshkrimit faktik të ngjarjes.

Aspekti i fundit, për shkak të të cilit u monitorua kjo fazë e procedurës, në asnjë vend të ligjit nuk është parashikuar, megjithatë nevoja që gjykata të bëjë një lloj të këtillë të verifikimit të pranimit të fajit nga ana e personit të akuzuar, të dhënë gjatë seancës së shqyrtimit kryesor, ka mbështetje të vet, si në teorinë juridike ashtu edhe në praktikë.

Teoria juridike është eksplicite për atë se pranimi i fajit, të cilin e jep personi i akuzuar, doemos duhet të jetë i plotë, përkatësisht gjykata doemos duhet të bindet se personi i akuzuar e pranon kryerjen e veprës penale, si në lidhje me ekzistimin e të gjitha karakteristikave ligjore të cilat e përbëjnë të njëjtën, ashtu edhe në lidhje me mënyrën e kryerjes, kohën dhe vendin e kryerjes së veprës penale, përkatësisht me përshkrimin faktik të ngjarjes. Në praktikë, në procedurat para gjykatave edhe personat paraprakisht të akuzuar e kanë pranuar fajin për vepra të kryera penale, por shpeshherë niveli i pranimit dhe përmbajtja e akuzës, nuk kanë qenë në detaje tërësisht identike.

Nëse gjykatat gjatë verifikimit të pranimi të fajit u përmbahen vetëm dispozitave të ligjit, është e mundshme që pranimi i këtillë i fajit të problematizohet më vonë.


Sipas të dhënave nga procedurat e monitoruara, në 70 procedura personat e akuzuar para gjykatës e kanë pranuar fajin.

Pranimi i fajit nga ana e personave të akuzuar, në 2 raste, fare nuk janë verifikuar nga ana e gjykatave, as në aspektin e asaj nëse pranimi i fajit është i plotë, dhe as në drejtimin e karakteristikave të veprës penale dhe përshkrimit faktik të ngjarjes, ndërsa në 9 lëndë, gjykata pjesërisht e ka verifikuar pranimin e fajit nga ana e personit të akuzuar në këtë drejtim.


Në 3 raste të pranimi të fajit, gjykata nuk e ka bërë verifikimin e pranimi vullnetar të fajit, ndërsa në 10 raste, verifikimi i këtillë është kryer vetëm pjesërisht.

Në lidhje me verifikimin e vetëdijes së personit të akuzuar, sa u përket pasojave nga pranimi i fajit, në 1 lëndë një verifikim i këtillë nuk është kryer, ndërsa në 14 lëndë është kryer vetëm pjesërisht.

A janë parashtruar pyetje që të verifikohet pranimi i fajit në drejtim të gjitha karakteristikave të veprës penale?



A janë parashtruar pyetje që të verifikohet aspekti vullnetar i pranimit të fajit?



Nga këndvështrimi i shifrave, gjendja në pjesën e pranimit të fajit, mund të vlerësohet pozitivisht, edhe nga aspekti i numrit të procedurave të cilat kanë përfunduar me pranim të fajit, me çka arrihet efikasitet gjatë procedimit edhe nga aspekti i sjelljes së gjykatave.

Megjithatë, gjendja reale, vë në dukje anomali dhe devijime të caktuara të dispozitave ligjore. Hyrja në fuqi e Rregullores për mënyrën e matjes së dënimeve në vitin 2014 dhe Ligjit për përcaktimin e llojit dhe matjen e lartësisë së dënimit nga data 07.07.2015 dhe konform të njëjtave, ndryshimet e KP në nenin 39, në lidhje me rregullat e përgjithshme të matjes së dënimit dhe nenin 40 dhe 41, në lidhje me zbutjen e dënimit, kanë impakt në sjelljen dhe interpretimin e ndryshëm nga ana e gjykatave gjatë zbatimit të dispozitave për pranimin e fajit.

Mbikëqyrësit, në procedurat në të cilat personat e akuzuar e kanë pranuar fajin, kanë vërejtur një numër të madh rastesh në të cilat gjykata i ka bindur personat e akuzuar ta pranojnë fajin, duke u sqaruar se “kështu është më mirë për ata”, meqë në këtë mënyrë dënimi do të mund t’u zbutet.

Nga ana tjetër, ndonjëherë gjykatat, duke u udhëhequr nga pamundësia për zbutjen e dënimit të personit të akuzuar nëse nuk e pranon fajin në shqyrtimin kryesor, në këtë drejtim e kanë aprovuar pranimin e fajit i cili është dhënë në fund të procedurës, gjatë marrjes në pyetje të personit të akuzuar, dhe jo në fazën fillestare siç është përcaktuar në LPP. Në këtë drejtim, në disa raste janë bërë vërejtje nga mbrojtja, në mënyrë që personat e akuzuar të fitojnë zbutje të dënimit, në përputhje me Rregulloren, ndërsa pastaj edhe

në përputhje me ligjin, janë detyruar t'i pranojnë plotësisht veprat penale, edhe pse çdoherë nuk pajtohen me përshkrimin faktik të ngjarjes dhe me karakteristikat e veprave penale, të cilat i përmban akuza.

Është vërejtur edhe një rast drastik kur gjykata që në fillim të seancës gjyqësore e ka pyetur të akuzuarin nëse me të vërtetë e ka kryer veprën, ka qenë rigjide me personin e akuzuar, nuk i ka ofruar kurrfarë udhëzimesh, nuk ia ka prezantuar provat edhe pse personi i akuzuar është deklaruar se nuk e ka kryer veprën dhe ka kërkuar t'i prezantohen provat, kështu që prokurori publik është ai i cili ia ka prezantuar provat dhe i cili e ka udhëzuar personin e akuzuar se është më së miri të angazhojë mbrojtës për rrjedhën e mëtutjeshme të procedurës, ndërsa u fitua përshtypje se gjykata është e interesuar që personi i akuzuar ta pranojë fajin, por jo edhe të zbatojë procedurë të ligjshme.

Në dy lëndë, mbrojtësit nuk u kanë lejuar personave të akuzuar ta pranojnë fajin në shqyrtimin kryesor, edhe pse të akuzuarit kanë pasur qëllim dhe interes të dukshëm që ta bëjnë një gjë të këtillë.

Tek pjesa e pranimit të fajit, ka vërejtje edhe nga mbikëqyrësit joprofesionistë të cilët po ashtu kanë regjistruar se gjykata i ka sugjeruar personit të akuzuar ta pranojë fajin, është vërejtur edhe një rast kur dy të akuzuar sipas sugjerimit të gjyqtarit dhe pas konsultimit me mbrojtësin e kanë pranuar fajin, ndërsa është bërë fjalë për veprën penale nga nenin 215 të KP, për të cilën janë akuzuar dy persona të moshuar-pensionistë, të cilët mbikëqyrësit nuk i kanë lënë përshtypje se e kanë kryer veprën.

PROCEDURA E PROVËS NË SEANCËN E SHQYRTIMIT KRYESOR

Në dispozitat e neneve 382 deri në 394 të LPP, është rregulluar procedura e provës në shqyrtimin kryesor para gjykatës. Të gjitha provat sipas rregullit duhet të nxirren në shqyrtimin kryesor, ndërsa marrja në pyetje e dëshmitarëve nuk mund të zëvendësohet me leximin e deklarimit gojor të dhënë paraprakisht gjatë procedurës ose me deklaratë të shkruar, përveç në disa përjashtime të parashikuara në nenin 288 të LPP.

Konstatimi dhe mendimi i personit ekspert mund të jetë edhe në formë të shkruar, por nëse njëra nga palët kërkon që personit ekspert t'i parashtrihen pyetje gjatë shqyrtimit kryesor, konstatimi me shkrim dhe mendimi do të pranohen si material provues, vetëm nëse personi ekspert i cili e ka hartuar konstatimin dhe mendimin e ekspertizës, ka dhënë deklaram


gojor në shqyrtimin kryesor dhe është ofruar mundësia t'i parashtrohen pyetje të kryqëzuara.

Gjatë procesit të monitorimit të shqyrtimit kryesor, e që është vetëm një pjesë e procedurës së re penale, nga mbikëqyrësit u kërkua të shënojnë nëse ndonjëra nga palët do të shprehej në ndonjë mënyrë se paraprakisht nuk i është ofruar mundësia gjatë procedurës të prezantojë ndonjë provë. Në pyetjen e formuluar në këtë mënyrë kemi vetëm një përgjigje pozitive, e cila madje edhe nuk është relevante, meqë personi i autorizuar i të dëmtuarit, i cili nuk është palë në procedurë, ka prezantuar konstatim dhe mendim dhe ka kërkuar të pranohet nga gjykata, në mënyrë që t'i realizojë të drejtat e tij edhe në procedura të tjera.

Nxjerrja e provave në seancën e shqyrtimit kryesor zhvillohet sipas radhës së përcaktuar me ligj: fillimisht provat e akuzës dhe provat në lidhje me kërkesën pronësore-juridike, pastaj provat e mbrojtjes. Pas tyre pasojnë provat e akuzës, për përgënjeshttrimin e provave të mbrojtjes – replikë dhe provave të mbrojtjes si përgjigje ndaj përgënjeshttrimit – kundër replikë.

Në procedurat e monitoruara, në 140 prej tyre, mbikëqyrësit kanë marrë pjesë në fazën e procedurës së provës dhe vetëm në 2 prej tyre ka pasur devijime nga radhitja ligjore të nxjerrjes së provave, kur gjykata për shkak të aspektit ekonomik të procedimit, në mungesë të dëshmitarëve të akuzës, ka vendosur të nxirren provat e mbrojtjes, e që është pak më shumë se 1% e të gjitha procedurave.

A ishte radhitja e nxjerrjes së provave në përputhje me radhitjen ligjore.



Nxjerrja e provave verbale – marrja në pyetje e dëshmitarëve, ekspertëve, këshilltarëve teknikë bëhet përmes parashtrimit të pyetjeve të drejtpërdrejta të kryqëzuara dhe plotësuese. Parashtrimin e pyetjeve të drejtpërdrejta e bën pala e cila e ka propozuar provën, parashtrimin e pyetjeve të kryqëzuara e bën pala kundërshtare, ndërsa parashtrimin e pyetjeve plotësuese e bën përsëri pala e cila e ka propozuar provën. Pas përfundimit të parashtrimit të pyetjeve nga ana e palëve, gjykata mund të parashtrrojë pyetje.

Pyetjet që kërkojnë përgjigje, sipas rregullit, lejohen vetëm gjatë pyetjeve të kryqëzuara, ndërsa gjatë pyetjeve të drejtpërdrejta dhe plotësuese vetëm për shkak të sqarimit të asaj që është thënë.

Qëllimi i pyetjeve të drejtpërdrejta është që përmes përgjigjes ndaj pyetjeve, të cilat parashtrohen, personi të cilit i parashtrohen pyetje ta prezantojë para gjykatës deklarin e tij gojor. Nga shkathtësia dhe përgatitja paraprake e personit i cili parashtron pyetje, do të varet nëse deklarimi gojor do ta arrijë qëllimin e vet, gjykatës i prezantohen faktet e rëndësishme për miratimin e vendimit përfundimtar. Sipas rregullit gjatë pyetjeve të drejtpërdrejta, përdoren të ashtuquajturat pyetje “të hapura” (pyetje të cilat fillojnë me kush, ku, kur, si, pse, plotësoni, sqaroni).

Në të vërtetë gjatë nxjerrjes së provave verbale, detyrimisht aplikohet vetëm një rregull – gjatë parashtrimit të pyetjeve të drejtpërdrejta nuk lejohen pyetje të cilat në vetvete e përmbajnë përgjigjen, përveç nëse parashtrohet pyetje për sqarimin e asaj që tanimë është thënë, ndërsa roli i gjykatës në pjesën më të madhe është të kujdeset për pyetjet e lejuara dhe relevante, ndërkaq nëse të njëjtat do të parashtrohen në formë adekuate, gjatë parashtrimit të pyetjeve të drejtpërdrejta dhe të kryqëzuara, më së shumti varet nga shkathtësia e palës dhe përgatitjes paraprake, megjithatë ndonjëherë edhe nga personaliteti i vet personit të cilit i parashtrohen pyetje dhe nevoja që pyetjet t'i përshtaten aftësisë së personit të njëjtë në mënyrë që t'i kuptojë dhe t'u përgjigjet.

Duke i pasur parasysh rolet e ndryshuara të gjykatës dhe palëve, sa i përket procedimit të deritanishëm, gjatë monitorimit të seancave të shqyrtimit kryesor, njëri nga qëllimet ishte të shihet se si pjesëmarrësit në procedurën penale gjenden në kushte të ndryshuara, gjykata e cila paraprakisht gjatë procedurës ka qenë aktive, e ka udhëhequr parashtrimin e pyetjeve, tani kalon në mbikëqyrës pasiv të të njëjtave, e cila mban llogari vetëm për atë që është e lejuar dhe relevante gjatë parashtrimit të pyetjeve dhe parashtrimit të drejtë të pyetjeve dhe vendos sipas kundërshtimeve të palëve, ndërsa

paditësi dhe mbrojtja tani kanë rol aktiv në parashtrimin e pyetjeve dhe në prezantimin e provave gjatë shqyrtimit.


Marrë në përgjithësi, gjatë monitorimit të shqyrtimeve kryesore, mbikëqyrësit kanë fituar përshtypje se gjykatat kanë qenë më të përgatitura gjatë zbatimit të Ligjit, ndërsa palët nuk kanë lënë përshtypje se janë të sigurta dhe të përgatitura, e që veçanërisht është vërejtur gjatë pyetjeve të kryqëzuara, të cilat shpeshherë kanë kaluar në pyetje të drejtpërdrejta, ndërkaq një mos-përgatitje dhe mosnjohje e veçantë e dispozitave ligjore është vërejtur tek një pjesë e mbrojtësve, kurse një pjesë e mbrojtësve sipas detyrës zyrtare kanë manifestuar mosinteresim evident.

Tek parashtrimi i pyetjeve të kryqëzuara, në disa raste, është paraqitur dyshimi nëse dëshmitari duhet doemos të përgjigjet me “po” ose “jo” ose ka të drejtë të jep sqarime.

Gjithashtu, në disa raste, kur është kërkuar nga mbrojtja, dëshmitari i prokurorisë të propozohet edhe si dëshmitar i mbrojtjes dhe t’i parashtrohen pyetje të drejtpërdrejta, meqë në pyetjet e drejtpërdrejta nga prokuroria nuk është pyetur për rrethanat e rëndësishme të mbrojtjes, gjykatat kanë marrë vendime të ndryshme. Për dallim nga kjo, gjykatat shpeshherë i kanë lejuar prokurorit publik gjatë pyetjeve të kryqëzuara ta pyes edhe në mënyrë të drejtpërdrejt dëshmitarin e mbrojtjes.

Në pjesën e parashtrimit të pyetjeve të drejtpërdrejta, gjatë procedurave në vijim, mbikëqyrësit kanë marrë pjesë në pyetjet e parashtruara drejtpërdrejt në 98 lëndë. Në 83 procedura ose 85%, kur i janë parashtruar pyetje të drejtpërdrejta dëshmitarit, ekspertit ose këshilltarit teknik, pyetjet kanë qenë të qarta dhe precize dhe kryesisht kanë filluar me kush, si, ku, kur dhe ngjashëm. Në 15 rastet e tjera, parashtruesi i pyetjeve vetëm pjesërisht ka parashtruar pyetje të qarta dhe precize.

A kanë qenë të qarta dhe precize pyetjet e drejtpërdrejta drejtuar dëshmitarit/personit ekspert?




Në lidhje me pyetjen e parashtruar mbikëqyrësve, pala e cila ka parashtruar pyetje të drejtpërdrejta a ka lënë përshtypje se e zotëron mirë rastin dhe e di se çka pyet, prokurorët publikë seriozisht e kanë kuptuar rolin e tyre të ri gjatë procedurës, kështu që përgjigjja e mbikëqyrësve në lidhje me pyetjet e drejtpërdrejta të kryera nga prokuroria ishte pozitive në 77 lëndë, ndërsa në 6 lëndë prokuroria ka lënë përshtypje të pjesshme se e zotëron rastin.

Tek mbrojtja, në 34 raste të parashtrimit të pyetjeve të drejtpërdrejta, përshtypja e mbikëqyrësve ka qenë pozitive, ndërsa në 5 raste mbrojtja vetëm pjesërisht ka lënë përshtypje se e zotëron mirë rastin.


Megjithatë, këtu duhet të merret parasysh edhe fakti se në një pjesë të procedurave personat e akuzuar nuk kanë pasur mbrojtës të tyre dhe ata vet kanë parashtruar pyetje.

Pala e cila parashtron pyetje të drejtpërdrejta a ka lënë përshtypje se e njej mirë lëndën?

Paditësi



Mbrojtja




Parashtrimi i pyetjeve të kryqëzuara nga pala e kundërt, e cila pason pas pyetjeve të drejtpërdrejta, ka vetëm një qëllim – diskreditim të deklaramit gojor të personit, ose të vet personit të cilit i parashtrihen pyetje, me ç'rast edhe përmbajtja e deklaramit të tij gojor do të vihet në dyshim. Shtrirja e pyetjeve të kryqëzuara, sipas rregullit, kufizohet në pyetjet e parashtruara gjatë

pyetjeve të drejtpërdrejta, megjithatë, pyetjet për diskreditimin e personalitetit të personit i cili është marrë në pyetje, lejohen çdoherë. Gjatë pyetjeve të kryqëzuara më së shpeshti përdoren pyetje “të mbyllura”, përkatësisht pyetje të cilat në vetvete përmbajnë përgjigje dhe ndaj këtyre pyetjeve personit të cilit i parashtrihen mund të jap përgjigje të shkurtër me “po”, “jo”, “nuk e di” dhe ngjashëm. Pyetjet e kryqëzuara kërkojnë përgatitje të mirë paraprake të parashtruesit të pyetjeve dhe njohje të të gjitha aspekteve të një ngjarjeje juridike-penale, në të kundërtën e njëjta mund të ndodh që të ketë më shumë dëm sesa dobi për palën e cila parashtron pyetje.

Parashtrimi i pyetjeve plotësuese çdoherë kufizohet vetëm në pyetjet e parashtruara gjatë pyetjeve të kryqëzuara. Qëllimi i pyetjeve plotësuese është sipas mundësive të korrigojë “dëmi” i shkaktuar gjatë parashtrimit të pyetjeve të kryqëzuara. Gjatë shqyrtimeve kryesore, në të cilat u zbatua mbikëqyrja, prokuroria/paditësi u kanë parashtruar pyetje të kryqëzuara gjithsej 29 dëshmitarëve/ekspertëve, ndërsa mbrojtja u ka parashtruar pyetje të kryqëzuara 24 dëshmitarëve/ekspertëve.

Në rastet në të cilët është zbatuar parashtrimi i pyetjeve të kryqëzuara, në 39 për qind të tyre, pyetjet janë parashtruar me një shtrirje më të gjerë nga ai që është përfshirë me pyetjet e drejtpërdrejta.

A ishte kufizuar parashtrimi i pyetjeve të kryqëzuara vetëm në pyetje të drejtpërdrejta?




Rregulli, që gjatë parashtrimit të pyetjeve të kryqëzuara të përdoren të ashtuquajturat pyetje të mbyllura, është zbatuar në 53 raste të parashtrimit


të pyetjeve, në 23 nuk janë përdorur pyetje të mbyllura, ndërsa në 2 raste të parashtrimit të pyetjeve, vetëm pjesërisht janë përdorur pyetjet e mbyllura.

Përqindja e lartë e rasteve në të cilat fare nuk janë përdorur pyetje të mbyllura, nuk do të thotë se çdoherë e vë në dukje përgatitjen e pamjaftueshme të palëve për parashtrimin e pyetjeve të kryqëzuara. Duke e pasur parasysh mënyrën e zbatimit të pyetjeve të kryqëzuara dhe qëllimin e tyre – diskreditimin, mbikëqyrësit e monitoruan edhe mënyrën e parashtrimit të pyetjeve nga aspekti i respektimit të personit i cili është marrë në pyetje.

A u zhvillua parashtrimi i pyetjeve të kryqëzuara duke e respektuar dëshmitarin/personin ekspert i cili është marrë në pyetje?



Në mënyrë të veçantë u parashtrua pyetja nëse pyetjet e kryqëzuara zhvillohen papengesa (pyetje, përgjigje) ose të njëjtat ndërpriten dhe pse. Gjatë zbatimit të pyetjeve të kryqëzuara, në 12 raste, mbikëqyrësit kanë vërejtur se të njëjtat nuk zhvillohen pa ndërprerje, më së shpeshti për shkak të regjistrimit të pyetjeve dhe përgjigjeve në procesverbal.



Tek mbikëqyrësit joprofesionistë, duke e pasur parasysh mosnjohjen e tyre të të drejtës në këtë pjesë, u kërkua vetëm ta shprehin përshtypjen e tyre si publik për atë se gjykata në rolin e saj të ndryshuar si pjesëmarrës pasiv në pjesën e marrjes në pyetje, palëve a u kanë dhënë kohë të mjaftueshme në dispozicion që ta zbatojnë parashtrimin e pyetjeve dhe të japin vlerësimin e tyre sa i përket perceptimit të tyre lidhur me pyetjet e parashtruara nga ana e palëve dhe gjykatës drejtuar dëshmitarëve, ekspertëve ose të akuzuarit, dhe gjatë kësaj personi i cili parashtron pyetje a parashtron pyetje të qarta dhe precize.


Vlerësimi është i përgjithshëm se gjykatat u kanë mundësuar palëve që marrjen në pyetje të dëshmitarëve dhe ekspertëve ta zbatojnë sipas vlerësimit personal, pa kufizimin e kohës së parashtrimit të pyetjeve. Kështu ka ndodhur në 153 nga procedurat e monitoruara, në 11 procedura, gjykata nuk u ka dhënë kohë të mjaftueshme palëve në mënyrë që ta zbatojnë parashtrimin e pyetjeve.

Përgjigjet në pyetjen e dytë ishin të ngjashme si edhe tek pyetjet në lidhje me qartësinë dhe precizitetin e pyetjeve të cilat i parashtrojnë palët, me fjalë të tjera, marrë në përgjithësi, palët kanë qenë të suksesshme, me atë që prokuroria ka qenë pak më e mirë në krahasim me mbrojtjen, ndërsa sa i përket gjykatës, kur e njëjta ka parashtruar pyetje, vetëm në një rast ajo nuk ka qenë mjaft e qartë.

Dispozita e nenit 388 të LPP, në lidhje me mundësinë gjatë parashtrimin të pyetjeve të përdoren deklaratimet gojore të dhëna në procedurën paraprake, gjatë pyetjeve të kryqëzuara, ose gjatë përgënjeshtimit të të dhënave të prezantuara, ose në përgjigjen e përgënjeshtimit, për shkak të vlerësimit të autenticitetit të deklaratimeve gojore të dhëna në shqyrtimin kryesor, është përdorur në 6 raste për shkak të vënies në dijeni të personit i cili është marrë

në pyetje, gjithashtu në 6 raste për shkak të jokonsistencës së deklaramit gojor dhe në 1 rast për shkak të refuzimit të personit i cili është marrë në pyetje t'u përgjigjet pyetjeve.

A u përdorën deklaramet gojore të dhëna në procedurën paraprake dhe për cilat shkaqe?



Qëllimi i monitorimit të procedurave ishte edhe kontrolli i sjelljes së gjykatës gjatë marrjes në pyetje, në aspekt të nenit 383 paragrafit 5, vet ajo të parashtrojë pyetje, si dhe nëse pyetjet e gjykatës janë të kufizuara për sqarime të përgjigjeve paraprakisht të dhëna apo gjykata këtë të drejtë të saj e përdor që të zbatojë marrje në pyetje të veçantë.


E drejta e gjykatës në fund të procesit të marrjes në pyetje të parashtrojë pyetje, duhet të përdoret në mënyrë shumë restriktive dhe vetëm në drejtim të sqarimit të paqartësive ose mospërputhjeve në deklaramet e bëra me gojë, ndërsa në asnjë rast nuk guxon të shndërrohet në parashtrues të plotë të pyetjeve, në të kundërtën gjykata do të bëhet “ndihmës” i njërës nga palët.

Gjykata, në 47 nga lëndët e monitoruara, e ka përdorur të drejtën e vet të parashtrojë pyetje.

Sa u përket përqindjeve, thuaja se në gjysmën e procedurave, gjykata u ka parashtruar pyetje plotësuese personave të marrë në pyetje, pas përfundimit të parashtrimin të pyetjeve nga ana e palëve. Mbikëqyrësit kanë regjistruar edhe një numër të madh rastesh në të cilat gjykata, duke e shfrytëzuar këtë të drejtë, në të vërtetë përsëri dëshmitarit i ka parashtruar pyetje.

Palët, gjatë shqyrtimeve të mbikëqyrura, nuk kanë qenë aktive në shfrytëzimin e të drejtës së kundërshtimit, kështu që nga 96 procedura të monitoruara, në të cilat mbikëqyrësit i janë përgjigjur kësaj pyetje, janë vërejtur 22 raste në të cilat prokuroria/paditësi i ka kundërshtuar pyetjet e palës së kundërt, 3 raste në të cilat mbrojtja i ka kundërshtuar pyetjet e parashtruara nga prokuroria ose i dëmtuari. Në pyetjet e parashtruara nga gjykata në një rast ka pasur kundërshtim nga ana e prokurorisë.


A e kundërshtonin palët mënyrën e parashtrimit të pyetjeve gjatë marrjes në pyetje dhe mbi cilën bazë?



Gjatë procedurës së provave, gjykata e kontrollon mënyrën dhe radhën e marrjes në pyetje, duke e pasur parasysh efikasitetin, aspektin ekonomik dhe respektimin e personalitetit të pjesëmarrësve në procedurë, vendos sipas kundërshtimeve të palëve, sa u përket pyetjeve të parashtruara, kujdeset për pyetjet e lejuara dhe relevante dhe për zhvillimin e drejtë të marrjes në pyetje.

Gjykatat, duke e përdorur të drejtën e tyre nga neni 385 paragrafi 7 që të kujdesen për pyetjet e lejuara, vlefshmërinë e përgjigjeve dhe për zhvillimin e drejtë të marrjes në pyetje, këtë të drejtë e kanë përdorur në 42 procedura, ndërsa në 3 procedura gjykata nuk ka intervenuar edhe pse, sipas vlerësimit të mbikëqyrësve, ka pasur nevojë për një gjë të këtillë. Sa u përket përqindjeve, gjykata ka pasur nevojë të intervenojë në 46% të rasteve.


A kujdeset gjykata për pyetjet e lejuara, vlefshmërinë e përgjigjeve dhe për zhvillimin e drejtë të marrjes në pyetje?



Në nenin 388, në paragrafët 3, 4 dhe 5, janë përcaktuar disa përjashtime nga rregulli i nxjerrjes së drejtpërdrejtë të provave gjatë shqyrtimit kryesor. Bëhet fjalë për rastet e deklarimeve gojore të bëra në seancën gjyqësore të provës, kur ka indicie në bazë të të cilave mund të konkludohet se dëshmitari ka qenë i ekspozuar ndaj dhunës, kërcënimit, premtimit të parave ose dobisë tjetër, që të mos dëshmojë ose të dëshmojë rrejshëm në shqyrtimin kryesor, si dhe në rastin kur personi i cili e ka bërë deklarinimin me gojë ka ndërruar jetë, është sëmurë psikikisht ose, krahas të gjitha mjeteve të parashikuara me ligj për gjetjen e tij, ka mbetur i paarritshëm.

Vetëm në 2 raste ose në 2% të procedurave të monitoruara, është zbatuar ndonjë nga konkluzionet nga nxjerrja e drejtpërdrejt e provave në shqyrtimin kryesor nga neni 388 të LPP. Në një rast është lexuar deklarimi gojor i palës së dëmtuar të bërë para personit të autorizuar dhe i verifikuar në noter, edhe pse një lloj i këtillë i provës nuk është i parashikuar e as që lejohet me ligj.


Në cilën mënyrë u nxorën provat me shkrim dhe ato materiale? (36)



Gjatë miratimit të Ligjit të ri të procedurës penale edhe gjatë periudhës së parë të zbatimit të tij ekzistonte një mëdyshje e caktuar për atë se në ç'mënyrë do të prezantohen (nxirren) provat me shkrim dhe ato materiale. Përkatësisht, duke e pasur parasysh atë që sipas konceptit të ri gjykata është pasive, nuk ishte e qartë nëse provat me shkrim dhe ato materiale do të nxirren me lexim dhe prezantim nga ana e gjykatës ose nga ana e palëve në procedurë.

Sipas përgjigjes në pyetësorët, provat e këtilla nxirren përmes leximit dhe prezantimit të të njëjtave nga ana e gjykatës në pjesën më të madhe të rasteve, përkatësisht në më shumë se 80% të shqyrtimeve të monitoruara. Me kërkesë të palës, më rrallë, provat e këtilla prezantohen ose lexohen gjatë marrjes në pyetje të dëshmitarit, përkatësisht ekspertit (kjo ndodhë vetëm në 5% të rasteve).

A kanë dëshmuar dhe sa kanë dëshmuar nëpunësit policorë? (37)




Në të drejtën komparative nëpunësit policorë shpeshherë paraqiten si dëshmitarë për çështje të caktuara. Çështja e përdorimit të nëpunësve policorë si dëshmitarë ndonjëherë paraqitet si mjaft kontroverse, veçanërisht këtu tek ne. Me fjalë të tjera, praktika e vendosur sipas LPP të vjetër kishte qëndrim kategorikisht negativ ndaj përdorimit të nëpunësve policorë si mjet dëshmues gjatë gjykimit. Sipas përgjigjeve të pyetësorëve të aplikuar, praktika e këtillë deri diku vazhdon edhe sipas LPP të ri, edhe pse ligji nuk ka dispozitë eksplicite e cila një gjë të këtillë do ta ndalojë. Megjithatë, duhet të pranojmë se numri (përqindja) i rasteve të këtilla nuk është i papërfillshëm dhe i njëjti shënon rritje (6% në vitin 2014, 8% në vitin 2015), kështu që do të ishte mirë kur ky numër do të krahasohej me praktikën e periudhës së para hyrjes në fuqi të LPP të ri.

Duhet të shënohet edhe ajo se çështja nuk është e qartë deri në fund në aspekt të asaj se a ka të bëjë vetëm me përdorimin e nëpunësve policorë në kuptim të sqarimit të saktësisë së procesverbaleve të caktuar në lidhje me veprimet e zbatuara në procedurën parahetimore ose hetimore ose ka të bëjë edhe me përdorimin e nëpunësve policorë si dëshmitarë për deklaratimet gojore që i ka dhënë i pandehuri ose dëshmitarët gjatë procedurës paraprake.

Deklarimet e këtilla gojore i pandehuri dhe persona të tjerë mund të japin (ndonjëherë edhe me iniciativë vetjake), jo vetëm gjatë marrjes në pyetje në stacionin policor, por edhe në vend tjetër gjatë bisedës joformale me nëpunësit policorë, në vendin e kryerjes së veprës penale, gjatë bisedës në ndonjë situatë tjetër (gjatë shoqërimit, në punë dhe ngjashëm), duke e pasur parasysh kompleksitetin e kësaj çështjeje të rëndësishme të njëjtës duhet t'i përkushtohet vëmendje e veçantë, ndërsa pyetja përkatëse nga pyetëtori të precizohet, sipas nevojës edhe të zbërthehet në më shumë pyetje.

A është marrë në pyetje personi i akuzuar?(38/19)




Me braktisjen e qasjes inkuizitore, i akuzuari tanimë nuk trajtohet si objekt i procedurës, e që në përputhje me LPP të vjetër dhe me praktikën e vendosur nga i njëjti sipas rregullit gjatë gjykimit merreshin në pyetje, e që në praktikë e vinte në pozitë të palakueshme vet personi të thirret në të drejtën e heshtjes. I akuzuari, në përputhje me nenin 391 të LPP, tani merret në pyetje vetëm me propozim të mbrojtjes (përkatësisht vetëm me iniciativën e tij). Sipas të dhënave në dispozicion nga pyetëtorët e mbikëqyrësve, i akuzuari është marrë në pyetje në shqyrtimin kryesor në gjysmën e rasteve të monitoruara (53% në vitin 2015 ose saktësisht 50% në vitin 2014).

Praktika e vendosur sipas LPP të ri, në masë të konsiderueshme dallon nga praktika paraprake gjyqësore.

Është mirë të shqyrtohet relacioni midis dëshmisë së të akuzuarit gjatë gjykimit në lidhje me deklarinin gojor të dhënë në procedurë paraprake. Me fjalë të tjera, i akuzuari i cili një herë ka dhënë deklarinin gojor para policisë ose para prokurorit publik ka problem serioz psikik dhe strategjik të heshtë (përkatësisht të mos jap deklarinin gojor), në procesin gjyqësor.


Do të ishte mirë të konstatohet edhe ajo se si gjykata e interpreton heshtjen, duke i pasur parasysh tendencat e reja në Evropë dhe në praktikën e Strasburgut, sipas të cilëve, në raste të caktuara në të cilat nga i akuzuari në mënyrë racionale duhet të pritët një sqarim i caktuar, heshtja mund të çojë edhe deri në konkluzione negative ndaj të akuzuarit.¹

A u mor në pyetje i akuzuari në lidhje me veprën penale? (39)



¹Praktika gjyqësore dhe teoria vendore nuk kanë qëndrim të qartë nëse tani kur i akuzuari është në një situatë më të relaksuar në lidhje me atë se a do të jap deklarinin gojor i njëjti duhet ta flas të vërtetën (siç është në shumicën e shteteve me procedurë akuzatore) ose mund të gënjejë pa pasur kurrfarë sanksionesh. Ngjashëm me këtë, LPP nuk e përcakton çka do të ndodhë nëse i akuzuari jep deklarinin gojor, por refuzon t'u përgjigjet pyetjeve të parashtruara. Shih: D. Iliq, Deklarimi gojor i të akuzuarit në procedurë penale, disertacioni i doktoratës, i mbrojtur në Fakultetin Juridik në Shkup në vitin 2012.


A u mor në pyetje i akuzuari në lidhje me rrethanat të cilat janë të rëndësishme për matjen e dënimit? (40)



Vitin e kaluar, në lidhje me atë se si është marrë në pyetje i akuzuari, mbikëqyrësit janë përgjigjur se i njëjti më së shpeshti është pyetur në lidhje me ngjarjen (60%), ndërsa më rrallë, përkatësisht 40% edhe për rrethana tjera, siç janë situatat personale dhe familjare, motivi dhe ngjashëm.

Nga përgjigjet në këtë pyetje mund të konkludohet se e njëjta akoma nuk është më adekuate meqë nuk mund të përcaktohet nëse për rrethanat e tjera i akuzuari është pyetur ekskluzivisht ose vetëm në mënyrë plotësuese. Nga ana tjetër, rrethanat siç është motivi dhe elemente të tjerë subjektivë ndërlidhen edhe me veprën penale dhe fajin, dhe jo vetëm me sanksionin. Kjo mund të jetë mjaft e rëndësishme nga aspekti i nismave për ndryshimin dhe plotësimin e LPP, sipas të cilave propozohet që procedura e vendimmarrjes të ndahet në dy faza, me ç'rast gjykata fillimisht do të diskutojë dhe vendos për fajin, ndërkaq më vonë në seancë të veçantë gjyqësore të diskutohet në lidhje me sanksionin.


Si u mor në pyetje i akuzuari i cili nuk ka mbrojtës? (41)



Gjatë zbatimit të LPP të ri u parashtrua një dyshim i caktuar për atë se si do të merret në pyetje i akuzuari i cili nuk ka mbrojtës, meqë teksti i ligjit në mënyrë eksplicite nuk e parashikon këtë situatë, madje edhe sikur presupozon se të gjithë të akuzuarit kanë mbrojtës i cili fillimisht do t'u shtrojë pyetje të drejtpërdrejta.


Sipas pyetësorëve, me sa duket, i akuzuari i cili nuk ka pasur mbrojtës është marrë në pyetje në mënyrë që fillimisht (sipas udhëzimit për të drejtën e heshtjes) ai vet e ka shpjeguar ngjarjen, ndërsa pastaj u përgjigjet pyetjeve të gjykatës. Për hir të së vërtetës, nga pyetësorët nuk mund të shihet në mënyrë të qartë se si janë kombinuar këto dy mënyra (i akuzuari vet e ka bërë shpjegimin në 38% të rasteve; vitin e kaluar – 41%, ndërsa në pyetjet e gjykatës u është përgjigjur në 59% të gjykimeve të monitoruara; ngjashëm edhe vitin e kaluar – 55%), meqë besohet se në një pjesë bukur të mirë të rasteve pyetjet e gjykatës janë parashtruar pas dhënies së deklaramit gojor në formë narrative nga ana e të akuzuarit.

A ka kërkuar prokurori publik të lexohet deklarimi gojor i të akuzuarit i dhënë në procedurën paraprake? (42)



Në lidhje me mundësinë e përdorimit të deklarimeve gojore të të akuzuarit, të dhëna në procedurën paraprake (në përputhje me nenin 391 paragrafin 3 dhe nenin 207 të LPP i cili parashikon edhe riprodhim të regjistrimit), përfshirë edhe situatën kontestuese për përdorimin e deklarimeve gojore të dhëna në polici, në prezencë të prokurorit publik, befason e dhëna se mundësia e këtillë nuk përdoret fare (njëlloj edhe në të dhënat për vitin 2014). Praktika e këtillë është me të vërtetë për t'u përshëndetur, duke e pasur parasysh se intenca kryesore e Ligjit të ri është që të gjitha provat të nxirren gjatë shqyrtimit publik dhe kontradiktor para gjykatës, ndërsa leximi i deklarimeve gojore paraprakisht të dhëna është lënë vetëm si opsion i cili do të shfrytëzohet me përjashtim. Nëse kjo është e saktë, atëherë kthesa e modelit dhe ideologjisë, në aspektin e braktisjes së elementeve inkuizitore gjatë procedurës, është realizuar më shpejtë dhe më lehtë nga ajo që është pritur.

Nëse po, i akuzuari a ka dhënë deklarin gojor gjatë shqyrtimit kryesor ose fare nuk ka dhënë deklarin gojor? (43)



Përgjigjja në pyetjen nëse i akuzuari ka dhënë deklarin gojor gjatë shqyrtimit kryesor ose nuk ka dhënë parashtrohet vetëm për rastin kur lexohet deklarimi gojor në kuptimin e pyetjes paraprake. Përkatësisht, pyetja ka për qëllim të verifikojë nëse leximi i deklarimit gojor si përjashtim nga parimi i aspektit të drejtpërdrejt dhe kontradiktor përdoret në rastet e mospërputhjes midis deklarimit gojor të dhënë në procedurën paraprake dhe në vet shqyrtimin apo gjatë përdorimit të të drejtës së heshtjes në shqyrtimin kryesor, ndërsa në situatën kur i akuzuari paraprakisht ka dhënë deklarin gojor gjatë hetimit.


Njëri nga problemet më aktual gjatë implementimit të LPP të ri ishte mungesa e kushteve materiale – teknike për regjistrimin e rrjedhës së shqyrtimit kryesor përmes incizimit ose përmes shënimeve stenografike. Për këto shkaqe, për rrjedhën e shqyrtimit mbahet procesverbal konform modelit të vjetër të diktimit të procesverbalit nga ana e kryetarit të kolegjit gjyqësor (53%), përkatësisht përmes diktimit dhe/ose shënimit të drejtpërdrejt të parashtimit të pyetjeve dhe përgjigjeve të drejtpërdrejta dhe të kryqëzuara (43%). Vitin e kaluar – 2014, raporti midis këtyre dy pozicioneve ishte i kundërt, e që në të vërtetë nuk është ndonjë dallim i rëndësishëm. E ngjashme është përgjigjja edhe tek mbikëqyrësit laikë (me diktim 51%).

Mënyra e këtillë (anakronike) e regjistrimit të rrjedhës së shqyrtimit kryesor jo vetëm që në masë të konsiderueshme e zvarritë procedurën, por seriozisht ndikon mbi dinamikën dhe efektivitetin e parashtimit të pyetjeve të kryqëzuara, për çka është e domosdoshme, një orë e më parë, të

akordohen mjete të mjaftueshme për këtë dedikim dhe t'i qaset krijimit të kushteve për regjistrim teknik (audio – video) ose përmes trajnimit të steno-daktilografisë. Së këtejmi deri në krijimin e kushteve për një gjë të këtillë, është e domosdoshme që në ndryshimet dhe plotësimet e LPP në mënyrë eksplicite ligjore të parashikohet mundësia e diktimit të procesverbalit nga ana e gjykatës, meqë praktika aktuale jo vetëm që është pengesë për realizimin efikas të mënyrës së re të nxjerrjes së provave nga ana e palëve, por edhe në mënyrë eksplicite është në kundërshtim me dispozitat e ligjit.

GJYKIMI I DREJTË – BARAZIA E ARMËVE

A u trajtua njëllor mbrojtja dhe prokurori nga ana e gjyqtarit në lidhje me propozimin e provave, kundërshtimeve, kërkesave për shtyrje dhe ngjashëm?(45 dhe 46/21)



Barazia e armëve është esenciale në gjykimin e drejtë dhe nënkupton mundësi të barabarta të palëve gjatë prezantimit të provave, si dhe trajtim të barabartë nga ana e gjykatës ndaj të dyja palëve. Përgjigjja e mbikëqyrësve në lidhje me pyetjen e barazisë tek kundërshtimet, kërkesat për shtyrjen dhe kërkesa të ngjashme procedurale është jashtëzakonisht i lartë, me çka me të vërtetë befason fakti se ata kanë vlerësuar se gjykata në mënyrë të barabartë i ka trajtuar të dyja palët, madje në 99% të rasteve të monitoruara (njëlloj edhe vitin e kaluar, 98%).

Pyetja në lidhje me atë nëse mbrojtja i ka pasur mundësitë e njëjta sikurse prokuroria gjatë propozimit të provave është akoma më e


rëndësishme dhe e paraqet esencën e të ashtuquajturës “barazia e armëve” dhe të gjykimit të ndershëm. Vlerësimi i mbikëqyrësve ndërlidhet me vlerësimin paraprak të trajtimit të barabartë të palëve, me ç’rast përsëri përqindja e përgjigjeve pozitive është e njëjtë 99% (vitin paraprak – 100%). Kjo shkon në favor të modelit të ri të procedurës penale, veçanërisht nëse e marrim parasysh se kundërshtimi më i shpeshtë i modelit paraprak, i të ashtuquajturës procedurë e kombinuar, ishte pikërisht në lidhje me (mos) barazinë e trajtimit të palëve, me ç’rast ishte e zakonshme teza se gjykata ka qëndrim të njëanshëm ndaj prokurorëve ose shtëpisë të caktuar, madje edhe qëndrim armiqësor ndaj mbrojtësve.

Edhe pse dëshirojmë të besojmë se procedura e re penale është më e drejtë në krahasim me procedurën e vjetër, kjo gjetje fantastike e mbikëqyrësve nuk është e thjeshtë për t’u sqaruar, duke i pasur parasysh kritikën serioze të cilat i adresohen gjyqësorit tonë edhe atë nga të gjitha anët (si nga ekspertë vendorë ashtu edhe nga ata të huaj, nga organizata qeveritare dhe joqeveritare). Veçanërisht avokatët dhe prokurorët ankohen për lëndët të cilat zhvillohen me procedurë të shkurtuar, ku ata, sipas fjalëve të tyre, nuk kanë pasur mundësi adekuate të përgatiten për gjykimin dhe në këtë drejtim të propozojnë prova përkatëse.

Pak më modeste janë gjetjet e mbikëqyrësve laikë, të cilët kanë vlerësuar se palët kanë pasur trajtim të barabartë në 87% të rasteve, në 6% ata nuk kanë pasur trajtim të këfillë (supozojmë në dëm të mbrojtjes), ndërsa në 7% të rasteve këta mbikëqyrës laikë nuk kanë mund të bëjnë vlerësim, kështu që janë përgjigjur me “nuk e di”.

E DREJTA E GJYKIMIT PUBLIK


A ishte gjykimi publik? (47)



Publiku gjatë gjyqimit është i rëndësishëm edhe për besimin e publikut ndaj gjyqësorit në kuptimin e kontrollit përkatës të publikut mbi punën e gjykatave, por edhe si e drejtë afirmative personale të akuzuarit i cili e mbron nga procedurat eventuale të njëanshme gjyqësore apo madje ndoshta edhe nga procedurat e “montuara” gjyqësore. Në publikun profesionistë dhe atë më të gjerë, në mënyrë të veçantë u problematizua përjashtimi i publikut në rastet e aplikimit të masave të veçanta hetimore dhe në rastet e përdorimit të dëshmitarëve të mbrojtur.² Projekti i monitorimit të procedurave nga ana e koalicionit “Të gjithë për gjykim të drejtë” megjithatë, tregoi se përjashtimet e këtilla janë shumë të rralla, 1% (ose në 2 raste) gjatë këtij viti, ndërsa asnjë rast gjatë vitit të kaluar 2014.

²Shih: G. Kallajxhiev, M. Konevska, “Zbatimi i masave të veçanta hetuese dhe përdorimi i provave të siguruar me të njëjtat në gjykimet në Republikën e Maqedonisë”, në: *Zbatimi praktik i masave të veçanta hetuese*, OSBE, Shkup, 2013.


A janë shpallur publikisht vendi dhe koha e gjykimit në tabelën jashtë sallës së gjykimit?(49)



Krahasuar me vitin e kaluar, në vitin 2015 vendi dhe koha e gjykimit janë shpallur publikisht në tabelë jashtë sallës së gjykimit në vetëm 88% të rasteve (në vitin 2014 thuaja se të gjitha rastet janë publikuar në shkallë solide 97%). Së këtëjmi, kjo tendencë duhet t'u vihet në dijeni personave kompetent të administratës gjyqësore, në mënyrë që publikut t'i sigurohet qasje adekuate në gjykimet publike.

Vetëm në 2 raste publiku dhe mediat janë përjashtuar, por për shkaqe ligjore.

A ishte përjashtuar publiku



Në literaturën dhe praktikën gjyqësore ka dyshime të caktuara nëse Ligji i ri në mënyrë të drejtë i parashikon rastet dhe shkaqet se kur mund të përjashtohet publiku tërësisht ose pjesërisht nga gjykimi. Së këtejmi, ishte diskutabile nëse bazat ligjore për përjashtimin e publikut janë kompatible me ato të theksuara me të drejtën dhe praktikën e KEDNJ.


Nga ana tjetër, dispozita për përjashtimin e publikut për shkak të ruajtjes së fshehtësisë shtetërore ose ushtarake, ngjashëm si edhe dispozitat e LPP në lidhje me dëshmitarët e obliguar që të ruajnë ndonjë fshehtësi të caktuar, është evidente se nuk është harmonizuar me Ligjin për informata të klasifikuara dhe me aktet përkatëse nënligjore të cilat përmbajnë një klasifikim të ndryshëm të të dhënave të mbrojtura, si dhe paqartësia e shfrytëzimit të mundësisë disa të dhëna të klasifikuara megjithatë të nxirren para personave të cilët posedojnë certifikatë adekuate.

E DREJTA PËR GJYKATË TË PAANSHME

E drejta për gjykatë të paanshme dhe të pavarur është njëra nga garancitë kryesore për gjykim të ndershëm. Instituti i përjashtimit të gjyqtarëve është njëri nga mekanizmat kryesor i cili palëve u siguron instrument ligjor për mbrojtjen e kësaj të drejte të rëndësishme. Në asnjë rast nuk është vërejtur kërkesë për përjashtimin e gjyqtarit.

A vërehej se gjyqtari ose porota tanimë kanë mendim të formuar i cili mund të ndikojë mbi vendimin? (52)

52




Në numrin më të madh të lëndëve të monitoruara nuk kishte dyshime sa i përket paanshmërisë gjyqësore të vërejtur nga ana e mbikëqyrësve, në kuptimin se gjyqtari ose gjyqtarët porotë tanimë e kanë formuar mendimin i cili mund të ndikojë mbi zhvillimin e procedurës dhe vendimmarrjes. Në 5 raste, mbikëqyrësit kanë pasur dyshime të caktuara e që ia vlen të analizohen në mënyrë të detajuar.

Ngjashëm, edhe vitin e kaluar, kur mbikëqyrësit kanë shfaqur dyshime sa i përket njëanshmërisë në vetëm tre nga rastet e mbikëqyrura në vitin 2014.

Nëse të dhënat e këtilla pozitive janë të sakta dhe reale – meqë gjyqtarë me përvojë nuk do të dorëzohen lehtësisht se kanë mendim paraprakisht të formuar për lëndën, që do të ndikonte mbi zhvillimin e procedurës dhe mbi vendimin gjyqësor – me kënaqësi mund të konkludohet se LPP i ri tanimë jep rezultate në njërën nga çështjet kryesore të reformës në drejtim të avancimit të gjykimit të drejtë. Nga ana tjetër, disa nga kritikrat kryesore të modelit të vjetër të procedurës penale ishin fokusuar pikërisht mbi ndikimin e dosjes dhe rezultateve të hetimit mbi trupin gjykues,³ dhe së këtejmi trupi gjykues tani paraprakisht nuk është i njoftuar me deklaratat e të akuzuarit dhe dëshmitarëve, meqë ato veçohen konform nenit 344 paragrafi 2 të LPP të ri, pikërisht për këtë shkak që të mos ndikojnë mbi gjykatën.

³Shih: D. Krapac, V. Kambovski, G. Buzharovska, G. Kallajxhiev, *Strategjia e reformës së të drejtës penale, Ministria e drejtësisë, Shkup, viti 2007, e aksesshme në: http://arhiva.vlada.mk/registar/files/strategjia_kazneno.pdf*


A sillet gjykata me frikësime ndaj cilësdo qoftë palë? (53/23)



Gjatë vitit të kaluar nuk janë vërejtur raste ekstreme të sjelljes joprofesionale, me ç'rast gjykata do të sillej me frikësim ndaj njëres nga palët, ndërkaq kjo është paraqitur vetëm në një rast, i cili mund të konsiderohet si incident. Raste të këtilla nuk kanë vërejtur as mbikëqyrësit laikë.⁴

Në mënyrë të ngjashme, gjykata nuk ka përdorur gjuhë diskriminuese ndaj ndonjëres nga palët në lidhje me gjininë e tyre, gjuhën, racën dhe ngjashëm.⁵ Konstatimin e njëjtë e kanë edhe mbikëqyrësit laikë.

A ishte gjykata e (pa) kujdesshme gjatë gjykimit?(55/25)




⁴Mund të mendohet që pyetja të anashkalohej në periudhën e ardhshme.

⁵Kjo pyetje, gjithashtu, mund të fshihet nga projektet e ardhshme të monitorimit.


Gjykata, gjithashtu, gjatë kohës së gjykimit në pjesën më të madhe të lëndëve të monitoruara ka pasur sjellje korrekte në aspektin e kujdesit përkatës dhe profesionalizmit. Megjithatë, në 10 raste mbikëqyrësit kanë pasur vërejtje dhe qëndrim kritik ndaj sjelljes së gjykatës.

A ka siguruar gjykata barazi procedurale për të dyja palët? (56)




Edhe një herë mbikëqyrësit kanë dhënë notë jashtëzakonisht të lartë për atë se gjykata i trajton në mënyrë të paanshme, me përgjegjësi dhe në mënyrë të barabartë palët e kundërshtare gjatë procedurës. Siç e theksuam paraprakisht, kjo është nga një këndvështrim i ndryshëm në të vërtetë është parashtruar pyetja e njëjtë me atë të barazisë së armëve (nr. 45 përkatësisht 21 tek mbikëqyrësit laikë).

A la gjykata përshtypje se është e njëanshme?(57)




A la gjykata përshtypje se e favorizon njërën nga palët?(58)



Këto dy pyetje mund të kritikohen në drejtimin e asaj se në mënyrë esenciale mbivendosen ndërmjet tyre edhe me disa pyetje të tjera paraprake (49, 56), megjithatë, tregojnë se gjetjet pozitive të mbikëqyrësve sa i përket paanshmërisë së gjykatës janë bindëse dhe unike. Kjo gjithsesi duhet të interpretohet si sukses i LPP të ri, ideja kryesore e të cilit ishte që ta çlirojë gjykatën nga roli i saj inkuizitor në lidhje me kërkimin aktiv të së vërtetës, meqë kjo e vendoste në një pozitë e cila nga aspekti faktik dhe psikologjik

është më e afërt me funksionin akuzator dhe me luftën kundër krimin. Së këtejmi, në mënyrë që ta përforcojë paanshmërinë e gjyqtarëve, me qëllim që ato fillimisht të fokusohen mbi sigurimin e barazisë midis palëve dhe mbi ligjshmërinë dhe drejtësinë e procedurës penale, LPP i ri jo vetëm që e eliminoi ndikimin e shkresave/dokumenteve hetuese mbi gjykimin, por plotësisht e shfuqizoi rolin aktiv të gjykatës në përcaktimin e të ashtuquajturës e vërteta materiale, ndërsa gjyqtarëve ua shkurtoi mundësinë që ata vet të propozojnë prova. Një shfuqizim të këtillë konsekuent të maksimës hetimore, në gjithë rajonin, u inkorporua vetëm në LPP tonë.


A kishte ex-parte komunikim jopërkatës?(59)



Gjetjet në 5 raste të komunikimit jopërkatës jashtë procedurës deri diku e prishin përshtypjen pozitive të gjetjeve paraprake në lidhje me pozitën e pakontestueshme joarbitrare dhe sjelljen e gjykatës ndaj palëve. Favorizimi i PP me të gjitha tezat për pasojat e solidaritetit dhe afërsisë midis gjyqtarëve dhe PP kundrejt të akuzuarve dhe mbrojtësve të tyre nuk janë vetëm problem i jurisprudencës tonë penale, por më shumë ose më pak janë dobësi thuaja se të të gjitha demokracive të reja.

PREZUMIMI I PAFAJËSISË

A ekzistonte diçka që do të sugjeronte se është cenuar prezumimi i pafajësisë ose se barra e provës gjatë gjykimit bie mbi të akuzuarin?
(60)



Në rastet e monitoruara nuk kishte kurrfarë dyshimi se është cenuar prezumimi i pafajësisë dhe rregulla e barrës së provës, me ç'rast në procedurat penale barra bie mbi prokurorinë. Sipas legjislacionit tonë një përjashtim i këtillë lejohet tek rastet e konfiskimit të zgjeruar, raste këto të cilat nuk kanë qenë të pranishme në proceset e monitoruara, dhe as që kanë ekzistuar dyshime se kundrejt normave ligjore obligimi i këtillë në të vërtetë i është bartur të akuzuarit.


Prezumimi i pafajësisë dhe *in dubio pro reo* – A është dëshmuar faji jashtë dyshimit të arsyeshëm?

Standardi i ri për shkallën e dëshmimit të nevojshëm për miratimin e aktgjykimit dënues ose lirues është i ri për të drejtën dhe praktikën tonë dhe përbëhet nga ndërmarrja e standardit anglosakson të dëshmimit “jashtë dyshimit të arsyeshëm” (beyond reasonable doubt). Bëhet fjalë për standardin e dëshmimit, i nevojshme për justifikimin e aktgjykimit dënues, i përfshirë në numrin më të madh të sistemeve akuzatorë juridik për dallim nga

standardi i deritanishëm, në LPP paraprak i përshkruar me “prova të mjaftueshme”.

Nga aspekti teorik, standardi i dëshmimit në LPP të ri është më i lartë, edhe pse është vështirë i njëjti të kuantifikohet. Në vitin 2014 mbikëqyrësit vlerësuan se ky standard është arritur në 75 për qind të lëndëve të monitoruara, megjithatë, përgjigjen e mirëfilltë do ta jap statistika përmes numrit më të vogël të aktgjykimeve dënuese nga viti i kaluar (kur ishte në fuqi LPP i vjetër).

Kuantifikimi i shkallës së probabilitetit/dëshmimit në fillim dhe në fund të gjykimit.




Në këtë situatë implementuam një hulumtim modest në lidhje me atë se si vlerësohen standardet ligjore, sa i përket shkallës së probabilitetit (dëshimit) në katër faza kryesore të procedurës. LPP i ri sanksionon standard të ri të probabilitetit (dëshimit) – “prova të mjaftueshme prej të cilave mund të pritët të miratohet aktgjykim dënues” (neni 319 të LPP), si standard i cili tani është i nevojshëm për ngritjen e akuzës, si dhe standardi i theksuar “prova jashtë dyshimit të arsyeshëm”, si standard i kërkuar për aktgjykim dënues (ndërsa në mënyrë eksplicite i përfshirë në nenin 403 i cili flet për aktgjykim lirues).⁶

Nga treguesit mund të konkludohet se qëndrimet e mbikëqyrësve janë të ngjashme me ato të grupeve të tjera të të anketuarve vendorë (gjyqtarë, prokurorë, avokatë dhe studentë) dhe nuk dallojnë shumë nga hulumtimet e ngjashme në SHBA. Shkalla e probabilitetit e nevojshme për të akuzuar është vlerësuar diç më pak se 70%. Përndryshe bëhet fjalë për standard i cili në LPP është vendosur në nivel më të lartë sesa më parë (fjalën e kemi për LPP të vjetër), kur barra e provës në të vërtetë ishte mbi gjykatën (i a.q. parimi hetues), ndërsa provat mblidheshin në kontinuitet, me mundësi që të propozohen madje edhe gjatë gjyimit, dhe jo rrallë herë edhe gjatë procedurës së mjeteve juridike. Tani, gjykata, aspak nuk mund të propozojë vet prova, ndërsa nga prokuroria pritët të gjitha provat t’i mbledh para se ta ngre akuzën, kështu që propozim plotësues të provave të reja lejohet më shumë si përjashtim sesa si punë normale, ashtu siç ishte më herët. Si përfundim, ajo që më së shumti na interesonte është se si vlerësohet standardi i ri për dëshmimin e fajit “jashtë dyshimit të arsyeshëm”. Pyetëtori tregoi se me këtë standard, të ndërmarrë nga e drejta anglosaksone dhe

